



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 13 (827920)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 prill 2025



16 *vjet*
NË NATO



**“Forca jonë në Shërbim
të Sigurisë dhe Paqes”**

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, z. Pirro Vengu priti në një takim, në Tiranë, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes së Sllovakisë, z. Robert Kalinák. Dy ministrat diskutuan rreth objektivave të mbrojtjes kolektive të Aleancës, sfidat e sigurisë dhe ndryshimet e rëndësishme në arkitekturën e mbrojtjes evropiane.

Ministri Vengu theksoi sesi aleatë të NATO-s, Shqipëria dhe Sllovakia janë të angazhuar të shtojnë bashkëpunimin përballë kërcënimeve, me të cilat po përballlet Evropa. Po ashtu, Ministri i Mbrojtjes shprehu gatishmërinë e Shqipërisë për të shtuar kontributin për sigurinë e kontinentit, duke rritur shpenzimet dhe investimet në mbrojtje. “Synimi ynë mbetet që deri në vitin 2030 të arrijmë në mënyrë graduale 3% të PBB-së për shpenzimet ushtarake”, - u shpreh ministri Vengu.

Duke evidentuar faktin se Sllovakia ka një industri të zhvilluar të mbrojtjes dhe synimin e Shqipërisë për risetimin e industrisë ushtarake, ministri Vengu kërkoi nga homologu sllovak shkëmbimin e praktikave dhe njohurive në fushën e industrisë së mbrojtjes. Në këtë aspekt, Ministri Vengu propozoi zhvillimin e konsultimeve dypalëshe për politikën e mbrojtjes mes ekspertëve të të dy shteteve, për të adresuar kërcënimet dhe sfidat e rajonit, mundësitë e ndërveprimit mes vendeve, përfshirë këtu edukimin, trajnimin, stërvitjet si dhe mjekësinë ushtarake.

Gjithashtu, në këtë takim, Ministri Vengu shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Sllovakia i ka dhënë vendit tonë në procesin e integritetit dhe përpjekjet sfiduese për të qenë pjesë e Bashkimit European brenda vitit 2030.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë vlerësoi qasjen konstruktive të Sllovakisë ndaj Kosovës.

Z. Vengu nënvizoi se stabiliteti në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për të gjithë Europën dhe Shqipëria do të mbetet e angazhuar për stabilitetin e rajonit, duke mbështetur misionet si KFOR dhe EUFOR. Ministrat e Mbrojtjes, të Shqipërisë dhe Sllovakisë, theksuan vijimin e mbështetjes për Ukrainën.



Ministri Vengu: Synimi ynë, deri në vitin 2030 të arrijmë 3% të PBB-së për shpenzimet ushtarake



STABILITETI NË BALLKANIN PERËNDIMOR ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TË GJITHË EUROPËN DHE SHQIPËRIA DO TË MBETET E ANGAZHUAR PËR STABILITETIN E RAJONIT, DUKE MBËSHTETUR MISIONET SI KFOR DHE EUFOR. MINISTRAT E MBROJTJES, TË SHQIPËRISË DHE SLLOVAKISË, THEKSUAN VIJIMIN E MBËSHTETJES PËR UKRAINËN.



16 Vjet në NATO: Forca jonë në Shërbim të Sigurisë dhe Paqes

Të nderuar ushtarë/detarë, nënoficerë, oficerë dhe punonjës civilë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Me krenari, kujtojmë një moment historik për Forcat e Armatosura dhe Republikën e Shqipërisë - 16 vite nga anëtarësimi në Aleancën Euroatlantike.

Ky ishte një moment që transformoi konceptin e sigurisë sonë kombëtare dhe shpalosi përkushtimin tonë të palëkundur ndaj sigurisë kolektive, vlerave të përbashkëta dhe kohezionit të Aleancës.

Që nga ky moment historik, ne kemi dëshmuar se Shqipëria nuk është thjesht një përfituese sigurie nga NATO, por një vlerë e shtuar dhe kontribuuese aktive në misionet dhe operacionet e saj në rajon dhe mbarë botën.

Në rrugëtimin si vend anëtar i NATO-s, Forcat e Armatosura janë transformuar dhe modernizuar në mënyrë të vazhdueshme, duke u bërë tërësisht të ndërveprueshme me forcat e Aleancës dhe duke qëndruar krah për krah me aleatët tanë për të mbrojtur stabilitetin rajonal dhe global.

Nga Ballkani në Afganistan, nga lufta kundër terrorizmit tek masat në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes në kufirin lindor të NATO-s, trupat shqiptare kanë shërbyer e vijojnë shërbimin me profesionalizëm, përkushtim dhe guxim.

Pjesëmarrja jonë aktive në misionet e NATO-s, si KFOR në Kosovë, EUFOR në Bosnje-Hercegovinë, misioni trajnues në Mbretëri të Bashkuar, detyrat në Detin Egje dhe angazhimet shumëkombëshe në Bullgari dhe Letoni, ka forcuar pozicionin tonë si një aleat i besueshëm dhe kontribuues në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Ndërsa bota përballlet me sfida në zhvillim të sigurisë, Forcat e Armatosura mbeten të palëkundura në rolin e tyre si një aleate e besueshme e NATO-s.

Ne do të vazhdojmë të kontribuojmë në përpjekjet e mbrojtjes kolektive, kundër kërcënimeve të reja dhe të mbështesim vlerat që na lidhin së bashku – lirinë, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Mbrojtja e vendit dhe ruajtja e sovranitetit kërkojnë një qasje proaktive dhe angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve, institucioneve dhe shoqërisë, përfshirë këtu përpjekjet e përbashkëta me vendet aleate dhe partnere, në rajon e më gjerë.

Në këtë drejtim, marrëveshjet për promovimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimin midis industrive të mbrojtjes, forcimin e ndërveprimit nëpërmjet edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve, kërcënimet hibride, si dhe mbështetjen e plotë për integrimin euroatlantik të vendeve aspirante, nuk duhet kurrësi të konsiderohen kërcënim por si përpjekje që do të zhvillojnë më tej bashkëpunimin, sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Anëtarësimi në NATO, jo vetëm që ka rritur sigurinë tonë kombëtare, por gjithashtu ka nxitur modernizimin dhe profesionalizimin e Forcave tona të Armatosura.

Në këtë drejtim, fokusi ynë është implementimi i projekteve të modernizimit të FARSH, me synim orientimin e procesit të modernizimit drejt paketave të plota të kapaciteteve për të përmbushur nevojat kombëtare dhe detyrimet ndaj aleancës.

Në aspektin e infrastrukturës kritike të mbrojtjes, inaugurimi i Bazës Ajrore Taktike të NATO-s në Kuçovë është një tjetër dëshmi e angazhimit tonë për të kontribuar në kapacitetet mbrojtëse kombëtare dhe të Aleancës.

Tashmë, kjo bazë do të shërbejë edhe si pikë strategjike për misionet e NATO-s në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë, duke rritur rolin dhe përgjegjësitë tona për paqen dhe sigurinë në rajon.

Për më tepër, kësaj infrastrukture strategjike do i shtohen edhe Korridori VIII dhe Porti i Ri i Porto-Romanos, si asete në funksion të përdorimit shumëdimensional kombëtar, si ekonomik, turistik, ushtarak, por edhe në dispozicion të mbështetjes së operacioneve të NATO-s.

Nëpërmjet stërvitjeve kombëtare apo me NATO-n, ne kemi testuar gatishmërinë,

rritur ndërveprueshmërinë me forcat aleate dhe përforcuar pozicionin tonë strategjik brenda komunitetit euroatlantik.

Ne mbetemi të përkushtuar, që përkrah aleatëve dhe partnerëve tanë, të kontribuojmë në adresimin e sfidave të shekullit të 21-të dhe promovimin e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë.

Vlerësimet pozitive që marrin Forcat tona të Armatosura në stërvitjet, operacionet apo strukturën e komandimit të NATO-s, përforcojnë përkushtimin tonë për të realizuar me sukses detyrën dhe për të zhvilluar më tej bashkëpunimin me vendet aleate dhe partnere. Siç e dëshmojmë çdo ditë, Shqipëria është një partner i besueshëm dhe i angazhuar, i gatshëm të përballojë çdo sfidë që mund të përballlet. Sot, më shumë se kurrë, vendi ka nevojë për një forcë të gatshme, të motivuar dhe të pajisur për të përballuar çdo sfidë që do të vijë. Prandaj, ju kërkoj të vazhdojmë me ritëm më të shpejtuar e të sigurt, të ndërtojmë një forcë të fortë, fleksibël dhe të denjë për të përballuar çdo sfidë kombëtare apo rajonale.

Ne mbyllje të këtij urimi, dua të shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata, burra e gra, me uniformë dhe pa uniformë, që kontribuan me përkushtim në materializimin e kësaj ngjarjeje madhore për mbarë popullin shqiptar. Faleminderit për përkushtimin dhe profesionalizmin tuaj të jashtëzakonshëm. Shqipëria dhe aleanca e NATO-s, ku marrim pjesë, është krenare dhe mirënjohëse për çdo moment të shërbimit tuaj. Gëzuar këtë përvjetor të 16-të!





Efektivët e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile përfunduan me sukses një tjetër mision në mbështetje të emergjencave civile në Bashkinë Vlorë.

Me mjete dhe motopompa thithëse me kapacitet të lartë, u bë largimi i ujit nga hidrovari, duke mbrojtur jetën dhe banesat e qytetarëve nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të ditëve të fundit.



Forca Tokësore përfundoi kursin “Junior Commanders Leadership”

Në Forcën Tokësore përfundoi me sukses “Junior Commanders Leadership Course”, i zhvilluar në bashkëpunim me instruktorë britanikë. Nëntogerët që ndjekin kursin bazë të oficerit kaluan një trajnim intensiv për aftësitë e udhëheqjes, vendimmarrjes dhe menaxhimit të situatave operationale.

Liderët e së nesërme përgatiten sot!



Ekipi EOD i Batalionit të Xhenios ndërhyri në fshatin Kolsh, Kukës, pas një thirrjeje urgjente nga autoritetet lokale për identifikimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme.

Pas verifikimeve, u konstatua se bëhej fjalë për predha artilerie të lëvizshme, të cilat u transportuan në mënyrë të sigurt për asgjësim të kontrolluar.

Operacioni u krye me profesionalizëm, duke eliminuar çdo rrezik për komunitetin.



187 rekrutë, mes tyre 21 femra, përmbyllën me sukses një nga etapat më të rëndësishme të formimit të tyre ushtarak në Regjimentin e Operacioneve Speciale, Regjimentin e Këmbësisë së Veriut, Vau Dejës, Shkodër dhe Regjimentin e Këmbësisë së Jugut Poshnje, Berat.

Përkushtimi, disiplina dhe përgatitja e tyre konfirmojnë angazhimin e Forcave të Armatosura për të ndërtuar një brez të ri ushtarakësh të gatshëm për sfidat e shërbimit në mbrojtje të atdheut.





Dëshmorët e Atdheut, dëshmia historike e frymëzimit në breza

“Dëshmorët e Atdheut”, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës 9-vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC-145 në Malësinë e Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor.

Prilli i para 9 viteve u ndal në gjysmë, pranverën e re nuk do e shijonin më dy djemtë e rinj, ‘shqiponjat e qiellit’, Floriani dhe Donaldi.

Sot dhe përgjithmonë ne do kujtojmë dëshmorët tanë, inspirimin e brezave në vite.

Dëshmorët janë ndërgjegjia më sublime dhe vetëdija e ngritur lart, deri në piedestalin e vetëflijimit. Breza të tërë pas nesh do i kujtojnë ata!

Dëshmorëve u këndohen këngë trimërie, si këto fjalë zemre që në vijë melodike vijnë për dëshmorët tanë:

*Nga Trupi po prapë
Shfaqet një ylber,
Flamur kuq e zi valëvitet në erë.
Është komandant Hoxha
Mbi helikopter.
Legjendë e vendit
Do mbetesh përherë.
Aty në ballkon ka mbetur nëna,
Me buzët që dridhen për djalin e saj.
Me mision u nise për të fundit herë,
Bashkë me Florianin ju mbetët
në qiell.
Ata që të njohin të kujtojnë me mall,
Dëshmorët e atdheut, përjetë
jeni gjallë.
Një shembull i ndritur,
Për brezat që vijnë.
Atdheut që deshët ia rritët lavdinë.*

Kujtimet e vetme që kemi për dëshmorët janë përmendoret, lapidarët dhe kujtesa historike që na bën të jemi krenarë.

I përjetshëm kujtimi i bijve tanë!



76 vite NATO

Kur dhe pse lindi NATO?

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, NATO, lindi më 4 prill 1949, kjo është dita në të cilën, në Uashington, u nënshkrua “Pakti Atlantik”, mbrojtja themeluese e NATO-s.

Ai u nënshkrua nga përfaqësues të 12 vendeve: Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Norvegjia, Holanda, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Konteksti i krijimit të NATO-s ishte ai i Luftës së Ftohtë, i dominuar nga dy blloqe të mëdha kundërshtarë, ai Lindor, i formuar nga Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tij satelitore, dhe ai Perëndimor, i udhëhequr nga SHBA-të dhe që përfshinte vendet që nënshkruan marrëveshjen.

Duke filluar nga viti 1953, kërret e saj zgjodhën si stemë një trëndafil ere me katër vija, një për çdo pikë kardinal, që simbolizonte rrugët ideale drejt paqes (të gjitha në një sfond blu, një aludim për Oqeanin Atlantik, emblemë e bashkimit midis Amerikës dhe Evropës).

“Qëllimi i NATO-s është të mbajë amerikanët brenda aleancës, rusët jashtë dhe gjermanët nën kontroll”, - deklaroi në atë kohë Sekretari i Përgjithshëm i saj, Hastings Lionel Ismay, në detyrë nga viti 1954 deri në 1957.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, SHBA-të donin të siguronin një prani ushtarake në arenën evropiane, në një çelës anti-rus, kontroll mbi Gjermaninë – përgjegjëse për konfliktin, e cila nga viti 1949 u nda në Gjermaninë Perëndimore dhe Lindore.

Qëllimi i NATO-s

Traktati i Atlantikut të Veriut (NATO) ishte kryesisht i fjetur derisa Lufta Koreane nisi krijimin e NATO-s për ta zbatuar atë, me anë të një strukture të integruar ushtarake, kjo përfshinte formimin e Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në 1951, i cili miratoi Strukturat dhe planet ushtarake të Western Union, duke përfshirë STANAG-të dhe SOFA-të dypalëshe. Në vitin 1952, u vendos posti i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, si shefi civil i organizatës. Atë vit u zhvilluan gjithashtu stërvitjet e para të mëdha detare të NATO-s, Stërvitjet “Mainbrace” dhe pranimi i Greqisë dhe Turqisë në organizatë. Pas Konferencave të Londrës dhe Parisit, Gjermanisë Perëndimore iu lejua të riarmatosej ushtarakisht, pasi ajo u bashkua me NATO-n, në maj 1955, e cila ishte, nga ana tjetër, një faktor kryesor në krijimin e Traktatit të Varshavës, të dominuar nga sovjetikët, duke përcaktuar dy anët kundërshtarë të Luftës së ftohtë. Ndërtimi i Murit të Berlinit, në vitin 1961, shënoi një kulm në tensionet e Luftës së Ftohtë, kur 400,000 trupa amerikane u vendosën në Evropë. Dyshimet mbi fuqinë e marrëdhënieve midis shteteve evropiane dhe Shteteve të Bashkuara u zbehën dhe rrodhën, së bashku me dyshimet mbi besueshmërinë e mbrojtjes së NATO-s kundër një pushtimi të mundshëm sovjetik, dyshime që çuan në zhvillimin e parandalimit të pavarur bërthamor francez dhe tërheqjes të Francës nga struktura ushtarake e NATO-s në vitin 1966. Në vitin 1982, Spanja iu bashkua aleancës. Revolucionet e vitit 1989 në Evropë çuan në një rivlerësim strategjik të qëllimit, natyrës, detyrave dhe fokusit të NATO-s në atë kontinent. Në tetor 1990, Gjermania Lindore u bë pjesë e Republikës Federale të Gjermanisë dhe aleancës, dhe në nëntor 1990, aleanca nënshkroi Traktatin për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë (CFE) në Paris me Bashkimin Sovjetik. Ai urdhëroi reduktime specifike ushtarake në të gjithë kontinentin, të cilat vazhduan pas rënies së Paktit të Varshavës, në shkurt 1991, dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në atë dhjetor, i cili largoi kundërshtarët kryesorë de fakto të NATO-s. Kjo filloi një tërheqje të shpenzimeve dhe pajisjeve ushtarake në Evropë. Traktati CFE lejoi nënshkruesit të hiqnin 52,000 pjesë të armatimeve konvencionale në gjashtëmbëdhjetë vitet e ardhshme, dhe lejoi që shpenzimet ushtarake nga anëtarët evropianë të NATO-s



● *Traktati i Atlantikut të Veriut (NATO) ishte kryesisht i fjetur derisa Lufta Koreane nisi krijimin e NATO-s për ta zbatuar atë, me anë të një strukture të integruar ushtarake, kjo përfshinte formimin e Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë (SHAPE) në 1951, i cili miratoi Strukturat dhe planet ushtarake të Western Union, duke përfshirë STANAG-të dhe SOFA-të dypalëshe.*

të bien me 28% nga 1990 deri në 2015. Në vitet 1990, organizata i zgjeroi aktivitetet e saj në situata politike dhe humanitare që nuk kishin qenë më parë shqetësime të NATO-s. Gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, organizata kreu ndërhyrjet e para ushtarake në Bosnje nga viti 1992 deri në 1995, dhe më vonë në Jugosllavi në vitin 1999. Këto konflikte motivuan një ristrukturim të madh ushtarak të pas Luftës së Ftohtë. Struktura ushtarake e NATO-s u shkurtua dhe u riorganizua me forca të reja, të tilla si Korpusi i Reagimit të Shpejtë të Komandës Aleate të Shtabit të Evropës. Ndryshimet e shkaktuara nga kolapsi i Bashkimit Sovjetik në ekuilibrin ushtarak në Evropë, që nga traktati CFE u njohën në Traktatin e Forcave të Armatosura Konvencionale të Përshtatura në Evropë, i cili u nënshkrua në samitin e Stambollit të vitit 1999. Politikisht, organizata kërkoi marrëdhënie më të mira me vendet e reja autonome të Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe forume diplomatike për bashkëpunimin rajonal midis NATO-s dhe fqinjëve të saj u krijuan gjatë kësaj periudhe të pas Luftës së Ftohtë, duke përfshirë nismën e Partneritetit për Paqe dhe Dialogut Mesdhetar në 1994, Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik në 1997 dhe Këshilli i Përhershëm i Përbashkët NATO-Rusi në 1998. Në samitin e Uashingtonit të vitit 1999, Hungaria, Polonia dhe Republika Çeke u bashkuan zyrtarisht në NATO dhe organizata gjithashtu nxori udhëzime të reja për anëtarësimin në “Plane Veprimi për Anëtarësim” të individualizuara. Këto plane rregulluan shtimin e anëtarëve të rinj të aleancës: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia në 2004, Shqipëria dhe Kroacia në 2009, Mali i Zi në 2017 dhe Maqedonia e Veriut në 2020. Zgjedhja e Presidentit francez Nicolas Sarkozy, në 2007, çoi në një reformë të madhe të pozicionit ushtarak të Francës, duke kulmuar me kthimin në anëtarësimin e plotë, më 4 prill 2009, e cila përfshinte

gjithashtu ribashkimin e Francës në Strukturën e Komandës Ushtarake të NATO-s, duke ruajtur një pengesë të pavarur bërthamore.

Neni 5 i traktatit të Atlantikut të Veriut, i cili kërkon që shtetet anëtare t'i vijnë në ndihmë çdo shteti anëtar që i nënshtrohet një sulmi të armatosur, u thirr për herë të parë dhe të vetme pas sulmeve të 11 shtatorit, pas të cilit trupat u vendosën në Afganistan, nën ISAF të udhëhequr nga NATO. Organizata ka operuar një sërë rolesh shtesë që atëherë, duke përfshirë dërgimin e trajnerëve në Irak, ndihmën në operacionet kundër piraterisë dhe në vitin 2011, zbatimin e një zone ndalim-fluturimi mbi Libi në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, 1973. Neni 4, i cili thjesht thirret në konsultim ndërmjet anëtarëve të NATO-s, është thirrur pesë herë pas incidenteve në Luftën e Irakut, Luftës Civile Siriane dhe aneksimit të Krimesë nga Rusia. Ky aneksim çoi në dënimin e fortë nga vendet e NATO-s dhe krijimin e një force të re “majë shtize” prej 5000 trupash në bazat në Estoni, Lituani, Letoni, Poloni, Rumani dhe Bullgari. Në samitin pasues të Uellsit, të vitit 2014, udhëheqësit e shteteve anëtare të NATO-s u zotuan zyrtarisht për herë të parë që të shpenzonin ekuivalentin e të paktën 2% të prodhimit të tyre të brendshëm bruto për mbrojtjen deri në vitin 2024, që më parë kishte qenë vetëm një udhëzues joformal. Në vitin 2014, vetëm 3 nga 30 anëtarë të NATO-s arritën këtë objektiv (përfshirë SHBA-në); deri në vitin 2020 kjo ishte rritur në 11. Të marra së bashku, në vitin 2020, 29 shtetet jo-anëtare të SHBA-së patën gjashtë vite radhazi rritje të shpenzimeve të mbrojtjes, duke e çuar shpenzimin e tyre mesatar në 1.73% të PBB-së. Anëtarët e NATO-s i kanë rezistuar Traktatit të Ndalimit të Armëve Bërthamore të OKB-së, një marrëveshje detyruese për negociatat për eliminimin total të armëve bërthamore, e mbështetur nga më shumë se 120 vende.



16 vite, Shqipëria në NATO

Gjatë viteve '80, Shqipëria ishte vendi më i izoluar i Evropës dhe pas rënies së Murit të Berlinit, strehë e rrënojës së fundit të komunizmit e diktaturës staliniste në kontinent. Deri në vitin 1990, aleanca e fundit ushtarake, pjesë e së cilës kishte qenë vendi ynë, ishte Traktati i Varshavës, anëtarët e të cilit përbëheshin nga të gjitha vendet e bllokut komunist të Evropës Lindore (me përjashtim të Jugosllavisë) dhe që udhëhiqej nga Bashkimi Sovjetik. Shqipëria ishte anëtarësuar në këtë aleancë në vitin 1955, për t'u shkëputur më pas përfundimisht në vitin 1968, pas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me këtë të fundit. Pas përmbysjes së regjimit komunist, Shqipëria iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, organizëm i krijuar nga NATO me qëllim rindërtimin e marrëdhënieve me vendet e dala nga Traktati i Varshavës.

Dy vite më vonë, më 23 shkurt 1994, Presidenti i Shqipërisë asokohe, nënshkroi Marrëveshjen e Partneritetit për Paqe mes NATO-s dhe vendeve të ish-bllokut komunist dhe paraqiti po në të njëjtën ditë, kërkesën zyrtare të Shqipërisë për t'iu bashkuar Aleancës. Kështu, në 1999, Shqipërisë iu dërgua Plani i Veprimit për Anëtarësimin, vendet anëtare të NATO-s nënshkruan Protokollin e Anëtarësimit për Shqipërinë dhe Kroacinë, në Samitin e Bukureshtit të mbajtur, më 2 prill 2008, dhe Shqipëria filloi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit, më 25 prill të po këtij viti.

Reformat e gjithanshme, të zbatuara me sukses, në kuadër të ratifikimit të protokollit, bënë që më 1 prill 2009, Shqipëria të anëtarësohej në strukturat e Aleancës, duke shënuar kështu një prej arritjeve më të mëdha historike për vendin, si dhe përmbushjen e një prej objektivave madhore të politikës së jashtme dhe sigurimin e avancimit të interesave kombëtare. Statusi i Shqipërisë, si vendi i parë ish-komunist që kishte shprehur haptazi dhe qartë, nëpërmjet një kërkesë zyrtare, vullnetin për anëtarësim në NATO, i dha asaj një rol të veçantë strategjik në Evropën Lindore, si një shtet, që megjithëse i vogël, kishte arritur të vendoste një trend të ri gjeopolitik për këtë pjesë të kontinentit.



Modernizimi i Forcave të Armatosura Shqiptare

Avantazhet më të mëdha dhe më të frytshme të bashkëpunimit të Shqipërisë me Aleancën e Atlantikut të Veriut, janë padyshim ato të fuqizimit ushtarak, modernizimit të teknologjisë ushtarake, si dhe forcimit e reformimit të institucioneve të mbrojtjes. Duke iu përgjigjur detyrimeve të vendit si aleat ndaj NATO-s, Forcat e Armatosura Shqiptare janë dërguar përgjatë 15 viteve të fundit për të kontribuar në një sërë misionesh të rëndësishme paqeruajtëse në Afganistan, Detin Egje, Irak, etj. Më 4 mars të këtij viti, u përurua baza e parë taktike ajrore e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ajo e Kuçovës. Ky projekt nisi në janar të dy viteve më parë dhe kushtoi rreth 45,8 milionë euro. Vendimi i Aleancës për të ndërtuar këtë bazë, pikërisht në Shqipëri, forcon jo vetëm bashkëpunimin mes saj e vendit tonë, por thekson gjithashtu edhe rolin strategjik ushtarak të Shqipërisë si aleati më i rëndësishëm

i Perëndimit në rajon.

Statusi i vendit anëtar të NATO-s, dhe së fundmi edhe ai i vendit kandidat në Bashkimin European, i japin Shqipërisë një pozicion të veçantë në kuadër të forcimit të sigurisë në Evropën Juglindore, në mbështetje të linjës politike të koordinimit të ngushtë mes Aleancës dhe Unionit, përballë kërcënimeve në rritje nga shtete me synime ekspansioniste, siç është Rusia. Sulmi në Ukrainë, i dënuar me ashpërsi nga NATO, ngriti së fundmi alarmin për sigurinë në Evropë, duke theksuar nevojën e rritjes së shpenzimeve qeveritare për mbrojtjen, për të arritur objektivin prej 2% të PBB (Prodhimit të Brendshëm Bruto), të miratuar unanimisht nga të gjitha vendet aleate në vitin 2014.

Duke pasur parasysh rritjen e influencës së Rusisë në Ballkan, të dhënat e raportit duhet të jenë kampionë alarmi për Shqipërinë si aleat kryesor i NATO-s dhe Perëndimit në këtë rajon delikat.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Roli i gruas në shoqëri ka evoluar ndjeshëm gjatë shekujve, duke kaluar nga kufizimet tradicionale në një pjesëmarrje gjithnjë e më të gjerë dhe të fuqishme në çdo aspekt të jetës. Në këtë rrugëtim, koha ka luajtur një rol vendimtar, duke reflektuar ndryshimet kulturore, ekonomike dhe shoqërore. Diversiteti ka sjellë një pasuri idesh dhe përvojash, ndërsa e ardhmja mbetet një mundësi e hapur për përparim dhe barazi më të madhe.

Në këtë ese do të analizojmë se si gruaja ka ndikuar dhe është ndikuar nga koha, si diversiteti ka formësuar rrugëtimin e saj dhe çfarë premton e ardhmja për një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Gruaja dhe Koha

Historia ka qenë shpesh një pengesë, por edhe një mundësi për gratë. Në të kaluarën, roli i tyre ishte kryesisht i kufizuar në familje dhe detyrat shtëpiake, ndërsa mundësitë për edukim, punë dhe drejtim ishin të pakta. Megjithatë, koha ka sjellë ndryshime të rëndësishme.

Në shekullin XX dhe XXI, gratë kanë fituar të drejta të rëndësishme, si e drejta për të votuar, për të punuar në çdo sektor dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje. Revolucioni teknologjik dhe ndryshimet sociale kanë hapur dyer të reja për gratë, duke i vendosur ato në pozita lidërshipi dhe duke u dhënë hapësira për të ndikuar në zhvillimin e shoqërisë.

Megjithatë, koha ende nuk ka sjellë barazi të plotë. Në shumë vende, gratë përballen ende me pabarazi në paga, mundësi të kufizuara për avancim dhe stereotipe që i ndalojnë të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Diversiteti dhe Roli i Gruas

Diversiteti është një nga faktorët kyç që ka ndihmuar në ndryshimin e statusit të gruas. Me një botë që po bëhet gjithnjë e më e ndërlidhur, gratë, nga kultura, raca dhe prejardhje të ndryshme, po sjellin përvoja të pasura që ndihmojnë në formësimin e një shoqërie më të hapur dhe gjithëpërfshirëse.

Në politikë, biznes, shkencë dhe art, gratë e çdo etnie dhe kulture po tregojnë se talenti dhe aftësia nuk njohin kufij. Përfshirja e diversitetit gjinor ka treguar se shoqëritë që mbështesin barazinë dhe shumëllojshmërinë janë më inovative, më produktive dhe më të suksesshme.

Për më tepër, diversiteti nuk është vetëm një çështje gjinore apo racore, por edhe një çështje e mundësive dhe zgjedhjeve. Gratë duhet të kenë lirinë për të zgjedhur rrugën e tyre pa u paragjykuar, qoftë si udhëheqëse politike, shkencëtare, sipërmarrëse apo si kujdestare familjare. Një shoqëri që e respekton këtë diversitet është një shoqëri më e drejtë dhe më e përparuar.

E Ardhmja: Çfarë Mund të Presim?

E ardhmja e gruas varet nga veprimet që ne ndërmarrim sot. Edukimi dhe fuqizimi ekonomik janë dy nga faktorët më të rëndësishëm që do të përcaktojnë rolin e grave në vitet që vijnë.

Teknologjia dhe inovacioni po krijojnë mundësi të reja për gratë në fusha si inteligjenca artificiale, inxhinieria dhe shkencat. Megjithatë, është e rëndësishme që gratë të kenë qasje të barabartë në këto mundësi dhe të mos mbeten pas për shkak të stereotipeve ose barrierave institucionale.

Ligjet dhe politikat duhet të vazhdojnë të mbështesin barazinë gjinore, duke siguruar paga të drejta, mundësi të barabarta dhe një mjedis pune që nuk diskriminon. Më shumë gra në poste drejtuese do të thotë më shumë modele frymëzuese për brezat e ardhshëm.

Gjithashtu, një nga sfidat më të mëdha është ndryshimi i mentalitetit shoqëror. Nëse duam një të ardhme më të

Gruaja, Koha, Diversiteti dhe e Ardhmja



drejtë, duhet të edukojmë fëmijët tanë që barazia gjinore nuk është vetëm një koncept teorik, por një vlerë që duhet të zbatohet në jetën e përditshme.

Gruaja, koha, diversiteti dhe e ardhmja, janë të ndërlidhura në një rrugëtim të gjatë drejt një shoqërie më të barabartë dhe të drejtë. Historia ka treguar se gratë janë të afta të kapërcejnë sfida të mëdha, ndërsa diversiteti ka sjellë një pasuri idesh dhe përvojash që forcojnë shoqërinë.

E ardhmja varet nga vendimet që marrim sot. Nëse vazhdojmë të mbështesim barazinë, të promovojmë diversitetin dhe të sigurojmë mundësi të barabarta, atëherë bota e së nesërme do të jetë një vend ku gratë nuk duhet të luftojnë për të drejtat e tyre, por të jetojnë me dinjitet dhe potencial të plotë.

Disfatat dhe Prioritetet: Mësime nga e Djeshmja dhe Rrugëtimi për të Nesërmen

Në çdo aspekt të jetës, qoftë në nivel personal, profesional apo shoqëror, disfatat dhe prioritetet luajnë një rol kyç në formësimin e së ardhmes.

Disfatat janë pjesë e pashmangshme e jetës dhe shpesh shërbejnë si mësim të vlefshme, ndërsa përcaktimi i prioriteteve ndihmon në arritjen e objektivave dhe shmangien e gabimeve të së kaluarës.

Në këtë ese, do të analizojmë rëndësinë e disfatave, si mund të mësojmë prej tyre dhe si të vendosim prioritetet për një të ardhme më të suksesshme dhe të balancuar.

Disfatat: Pjesë e Rrugës Drejt Suksesit

Disfatat shpesh perceptohen si fundi i një rrugëtimi, por në të vërtetë ato janë një mundësi për të mësuar dhe për të forcuar karakterin. Nuk ka sukses pa dështime, dhe historia ka treguar se shumë nga figurat më të njohura kanë kaluar nëpër disfata të shumta përpara se të arrinin qëllimet e tyre.

Disfatat në jetën personale

Në jetën e përditshme, njerëzit përballen me humbje, zhgënjime dhe sfida që mund t'i bëjnë të ndihen të pafuqishëm. Një marrëdhënie e dështuar, një miqësi e humbur apo një mundësi e shpërdoruar mund të duket si një humbje e madhe, por gjithmonë ka një mësim pas çdo disfate. Mënyra se si një person zgjedh të reagojë ndaj këtyre sfidave përcakton forcën dhe rritjen e tij.

Disfatat në karrierë dhe arsim

Shumë njerëz e përjetojnë dështimin në karrierë ose arsim si një pengesë të pakalueshme. Një provim i dështuar, një intervistë pune e pasuksesshme ose një biznes që nuk funksionon mund të jenë goditje të rënda për vetëbesimin. Megjithatë, shumica e sipërmarrësve të suksesshëm dhe liderëve kanë kaluar nëpër shumë dështime përpara se

të arrinin majat e suksesit. Më e rëndësishmja është të mësohet nga gabimet dhe të vazhdohet me një qasje të përmirësuar.

Disfatat në shoqëri

Në nivel shoqëror, historia ka treguar se shumë përpjekje për drejtësi dhe progres kanë hasur në pengesa dhe disfata të shumta. Lufta për të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe drejtësia sociale kanë qenë të mbushura me momente dëshpëruese, por përkushtimi dhe vendosmëria e njerëzve kanë bërë të mundur arritjen e ndryshimeve të mëdha.

Prioritetet: Çelësi për një të Ardhme më të Mirë

Pasi kemi kuptuar se disfatat janë pjesë e rrugëtimin tonë, është e rëndësishme të përcaktojmë prioritetet për të siguruar që të mësojmë prej tyre dhe të ndërtojmë një të ardhme më të suksesshme.

Prioritetet personale

Të dish çfarë është më e rëndësishme në jetën tënde është hapi i parë drejt suksesit dhe lumturisë. A duhet të përqendrohesh më shumë tek familja, tek shëndeti apo tek zhvillimi vetjak? Shpesh, njerëzit harxhojnë kohën dhe energjinë në gjëra të parëndësishme, duke humbur nga sytë vlerat e vërteta që i bëjnë të lumtur dhe të përmbushur. Vendosja e prioriteteve ndihmon në ruajtjen e një ekuilibri mes jetës personale dhe përgjegjësi të tjera.

Prioritetet në karrierë

Në një botë të mbushur me mundësi dhe sfida, është e rëndësishme të kesh një vizion të qartë për karrierën. Cili është qëllimi përfundimtar? Cilët hapa duhen ndërmarrë për të arritur aty? Përqendrimi në zhvillimin e aftësive, ndërtimi i një rrjeti profesional dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë prioritetet që ndihmojnë në avancimin e karrierës.

Prioritetet shoqërore

Një shoqëri e shëndetshme është ajo që vlerëson drejtësinë, solidaritetin dhe zhvillimin. Prioritetet duhet të përqendrohen në ndërtimin e një komuniteti më të mirë, ku respektohet diversiteti dhe ndihmohet njëri-tjetri. Edukimi, mbrojtja e mjedisit dhe barazia janë disa nga aspektet që duhet të jenë në qendër të politikave dhe angazhimit të shoqërisë.

Prioritetet për të ardhmen

Në një botë që ndryshon me shpejtësi, është e rëndësishme të mendosh për të ardhmen dhe të përgatitesh për të. Teknologjia, inovacioni dhe ndryshimet klimatike janë faktorë që do të ndikojnë në mënyrën si jetojmë. Prandaj, investimi në edukim, zhvillimi i qëndrueshëm dhe ndërtimi i politikave që mbrojnë interesat afatgjata janë prioritetet që nuk mund të anashkalohen.

Fatri Nesimi, skënderbegasi i ‘Medaljes së artë’, sot inxhinier i njohur i elektronikës dhe sipërmarrës në SHBA

Prof. Dr. Fatri Nesimi u lind më 1969, në Rabdisht të rrethit Dibër, sot, njëri prej 100 fshatrave turistike të Shqipërisë. Një fshat me një natyrë të bukur, me shtëpi karakteristike të gurta dhe me njerëz të mirë e punëtorë, mikpritës e patriotë. Familja ku u rrit ai, ishte një familje e madhe me 10 fëmijë (5 djem e 5 vajza), familje me tradita patriotike dhe arsimdashëse. Motoja me të cilën i ushqenin prindërit ishte “bëni më të mirën e mundshme!”. Babai i tij Xhelil Nesimi dhe gjyshi i tij Ali Nesimi, një prej të mbijetuarve gjatë djegies së fshatit nga serbët në vitin 1913, ishin burra që u peshonte fjala e patriotë. Kurse nëna e tij ka qenë një grua e fortë dhe aktive në kurset kundër analfabetizmit. Shkollën 8-vjeçare ai e kreu në shkollën “Shemsi Haka”, në fshatin Bellovë të Dibrës. Që në vitet e shkollës fillore ai spikati për rezultatet e larta dhe për edukatën që ai përcillte në marrëdhëniet me mësuesit dhe nxënësit. Ai nuk lodhej së mësuarit e lexuarit, por edhe së ndihmuar shoqet e shokët më të dobët, sidomos në lëndët ekzakte.

Duke qenë se ai vinte nga një familje patriotike, pavarësisht dëshirës së tij për të ndjekur një shkollë profesionale, për të filluar punë sa më shpejt për të ndihmuar ekonomikisht familjen, Fatriu përzgjidhet për t’u dërguar me studime në shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, të, cilën e kreu në vitet 1983-1987 me rezultate të shkëlqyera. Gjatë studimeve në këtë shkollë, ai u shqua si një nxënës sistematik dhe punëtor, si djalë me edukatë të lartë dhe që gëzonte respektin e të gjithë shokëve dhe të personelit pedagogjik dhe atij ushtarak.

Veçanërisht ai spikati në lëndët ekzakte, ndonëse i pëlqente të gjitha lëndët. Si pjesëmarrës në kompeticione të ndryshme të shkollave të mesme dhe gjithnjë ai kornte suksese.

Si rrjedhojë e rezultateve të shkëlqyera, duke siguruar një mesatare 10, Fatriut i akordohet një bursë studimi pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në degën Elektronikë. Gëzimi i Fatriut ishte i papërmbajtshëm kur mori lajmin se do të studionte në Universitetin Politeknik, moment ky që do i ndryshonte jetën. Në atë fakultet kishte konkurrencë të madhe, se aty ishin 50 studentët më të mirë nga gjithë Shqipëria.

Ai pati fatin që gjatë studimeve të tij të bëhet pjesë aktive e lëvizjes studentore të “Dhjetorit 1990”. Edhe këto studime ai i kreu me rezultate të shkëlqyera në vitin 1992. Menjëherë emërohet si pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, në Degën e Ndërlidhjes, ku jep lëndën Elektronikë. Ai shquhej për punën cilësore dhe zellin e tij. Por gjithsesi ishte i pakënaqur me veten, kërkonte më shumë, kërkonte të specializohej.

Kështu si shumë të rinj, pas vështirësive e peripecive, edhe Fatriu i drejtohet emigracionit. Ai shkon në SHBA, në Brooklyn, New York, ku jeton edhe sot. Menjëherë, krahas punëve të vështira, për të mbijetuar, ku ai nisi si kamerier dhe duke ndjekur kurse informatike. Ai angazhohet sërish në studime në “College of Technology”, për informatikë. Pas kësaj nis punë në këtë fushë si specialist i spikatur. Përsëri 2008-2010 ai bën Master në degën e Informatikës pranë Universitetit të New Yorkut, që ende pa mbaruar studimet e punëson Fatriun si pjesë e një grupi inxhinierësh të Informatikës për prodhimin e një programi, aplikacion për menaxhimin e leksioneve në mënyrë të automatizuar për kurset on-line, program që bëri bujë menjëherë në tregun amerikan dhe u ble nga kompania më e madhe konsulente “Accenture”, e cila emëron menjëherë Fatriun si kryeinxhinier të skuadrës. Pas kësaj ai liçensohet me EA për sistemin e taksave personale dhe të biznesit Amerikan, në vitin 2010-2011. Kudo ku punon Fatriu shquhet me korrektësinë dhe profesionalizmin e lartë. Pikërisht për këto, ai herë pas here certifikohet në Mikrosft Corporation si MCP dhe MCADdei në vitin 2005. Së fundmi, në vitin 2018 ai certifikohet në Site Core. Më vonë ai fillon punë në British Telecom të Amerikës, ku punon plot 14



vite. Aktualisht ai punon pranë firmës “Valtech”, e specializuar në programet informatike për korporatat mbarë botërore. Krahas punës në kompani ai zotëron edhe një biznes të vogël, në fushën e taksimit, ku ndihmon kryesisht shqiptarët në përgatitjen e bilancit përfundimtar të taksave personale në sezonin janar-prill.

Falë teknologjisë ne mundëm të kontaktojmë me Fatriun dhe t’i marrim disa mbresa nga jeta në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Ja si e kujton ai plot emocion: “...Në shkollën ‘Skënderbej’ u ambientova shpejt, me shokët, komandantët dhe mësuesit e mi. Emocionohem kur kujtoj sa shpejt i lidhëm shoqëritë e sa të forta janë ato dhe sot e kësaj dite. Në atë shkollë mua më pëlqente gjithçka, që nga ambientet e bollshme për jetesë, stërvitje dhe argëtim. Gjithnjë në jetën time në atë shkollë jam përpjekur të jap më të mirën time në çdo aspekt e detyrë që më ngarkohej. Nuk mund të mos nënvizoj ndihmën e trupës pedagogjike e ushtarake, tamam si prindër të vërtetë. Vështirë të veçoj emra mësuesish e edukatorësh. Secili më i talentuar se tjetri, secili unik. Por është krejtësisht e pamundur të mos kujtoj mësuesin e matematikës Asimaq Proko, Gjerqina Spahiun, Vera Stefën, apo mësuesen e fizikës, uniken, Ana Prifti, ‘...tash kena provim djema’, zemërbutën e kimisë Sajnira Dedej, që ta bënte lëndën të lehtë me aftësinë e saj, të mirën e letërsisë Sashenka Deli, të ndërën Lida Gjçali, e shumë e shumë të tjerë, që u kërkoj ndjesë për mos përmendjen. Kujtoj një moment shumë të rëndësishëm të jetës sime, një moment që ma ndryshoi vërtetë atë. Është momenti kur mu komunikua se

më është akorduar bursë studimi për Inxhinieri Elektronike pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Nuk dija si ta shprehja gëzimin dhe më besoni e shpreha me lot. Dua të theksoj se aty në atë shkollë zgjidheshin stafi pedagogjik, sepse ata kishin barrën që të bënin edhe rolin e prindit për ne. Ata ishin të dashur e të hapur me ne. E ne më shumë i donim ata. Ne 14-vjeçarët që gjetëm një familje të dytë më të madhe, ndjeheshim mirë, ndjeheshim të sigurt. Këta mësues dallonin edhe për punën e diferencuar me nxënësit e dobët, duke ngritur e menaxhuar grupet e ndihmës me nxënës të mirë e të dobët. Më duhet të ndalem tek stafi edukativ ushtarak, me të cilët kalonim 50% të kohës. Përveç rregullit, disiplinës, pastërtisë dhe edukatës, ata na mësuan një gjë shumë të rëndësishme, që për hir të së vërtetës duhet thënë, se na u kthye në natyrë të dytë ne skënderbegasve, vendosmëria për të mos u dorëzuar para vështirësive. Për mua emocion të veçantë përcillte puna prodhuese, kudo që është zhvilluar ajo, në aksione në bujqësi apo gjetkë. Aty mësonim emocionin që të jep vështirësia e punës, realizimi i normës, njohja e prodhimit, etj. Një vend të fuqishëm në memorien time zë edhe stërvitja dimërore, të cilën ne e kemi zhvilluar në Voskopojë. Ai muaj ishte me të vërtetë kalitje ushtarake. Aty sikur rriteshim, sikur burrëroheshim. Ndonëse ajo boria e alarmit të rrëqethte mishtë, sërish na vjen, me jo pak nostalgji, në kujtesën tonë se si ne realizonim ‘detyrat’ që na ‘ngarkonte’ Atdheu”.

Nga “Skënderbegas ndër vite”, për gazetën “Ushtria”.

Shpenzimet e mbrojtjes dhe tendencat e prokurimit

Në përgjigje të perceptimeve në rritje të kërcënimeve, shpenzimet globale të mbrojtjes janë rritur, me vendet në Azi dhe Evropë që kryejnë rritje të konsiderueshme buxhetore. Ndërsa shtetet punojnë për grumbullimin e shpejtë të municioneve, janë shfaqur teknika dhe teknologji të reja të prodhimit, të cilat mund të riformësojnë një pjesë të peizazhit mbrojtës-industrial.

Ri-bazimi i industrisë së mbrojtjes

Lufta e Rusisë në Ukrainë ka ekspozuar ashpër reduktimet e inventarit brenda shumë anëtarëve të NATO-s, që ndodhën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Tradicionalisht, korrigjimi i kësaj do të ishte arritur thjesht duke blerë sasi shumë më të mëdha pajisjesh, të tilla si raketa, mjete ajrore të pabanuara (UAV) ose municione, dhe grumbullimin e tyre në rast lufte. Kjo ndodhi sepse ciklet e prokurimit dhe prodhimit, të matura në vite dhe jo në muaj, nuk ishin në gjendje të përballonin rritjet e kërkesës për të përballuar më shpejt një mjedis të përkeqësuar të sigurisë, apo edhe shpërthimin e armiqësive. Megjithatë, kjo po ndryshon pasi teknikat dhe teknologjitë e reja të prodhimit shfaqen në kombinim me hyrjet e reja përçarëse që ofrojnë për të riformuar pjesë të peizazhit të mbrojtjes-industriale.

Disa faktorë kontribuojnë në atë që po shpaloset. Një kuadër i start-up-eve të mbrojtjes po përqafon mënyra të reja prodhimi për të ulur kostot dhe për të vepruar me shkathhtësi të shtuar. Ekziston gjithashtu një njohje midis disa qarqeve të larta ushtarake dhe politike se modelet e vjetra të blerjes dhe prodhimit të mbrojtjes nuk janë më plotësisht të përshtatshme për qëllimin. Baza ekzistuese e mbrojtjes-industriale po orientohet më shumë drejt një baze lufte, ndërsa lojtarët në zhvillim inkurajohen të ofrojnë përgjigje të ndryshme dhe më të shpejta për të përmbushur nevojat materiale të mbrojtjes.

Në vitin 2024, atëherë Zëvendës Sekretarja e Mbrojtjes e SHBA-së, Kathleen Hicks tha se “baza industriale e mbrojtjes së Amerikës është në një moment kyç”, me pandeminë COVID-19 që zbulon brishtësinë e zinxhirëve të furnizimit, së bashku me luftën e Rusisë në Ukrainë, pushtimin e Gazës nga Izraeli dhe inkursionin e tij në Liban, duke nënvizuar rëndësinë, kapacitetin e prodhimit dhe ndonjëherë mungesën e kapacitetit të prodhimit.

MAFAT i Izraelit, Drejtorja e Kërkimit dhe Zhvillimit të Mbrojtjes së vendit, priti një seminar të prodhimit të avancuar ndërsa vendi po përballej me kërkesat konkurruese të luftimeve në Gaza dhe Liban, ndërsa gjatë gjithë kohës mbështeste mbrojtjen kombëtare raketore. Këto kërkesa kanë tensionuar prodhimin industrial të Izraelit, nga municionet te raketat e mbrojtjes ajrore. Në mbledhje, kreu i MAFAT-it, Daniel Gold i kërkoi industrisë të përqafojë prodhimin masiv dhe automatizimin dhe argumentoi më tej për inovacionin vendas. Seminari u fokusua në tema si printimi 3D, përdorimi i automatizimit dhe robotikës në prodhim, dhe metodat inovative të prodhimit.

Në Shtetet e Bashkuara, një bartës i flamurit për një qasje përçarëse ndaj prodhimit të mbrojtjes është kompania fillestare e mbrojtjes “Anduril Industries”. Në gusht 2024, kompania zbuloi planet për një strukturë të madhe të prodhimit të mbrojtjes, e aftë për të prodhuar mijëra automjete të pabanuara çdo vit. Me më shumë se 460,000 metra katror hapësirë, objekti pothuajse do t’i afrohej madhësisë së vetë Pentagonit dhe do të ishte një nga objektet më të mëdha të prodhimit në botë. Fillimi zbuloi ambicien menjëherë pas përfundimit të një raundi investimi 1.5 miliardë dollarësh ‘Seria F’ që vlerësonte biznesin shtatëvjeçar në 14 miliardë dollarë.

Shefi i strategjisë së “Anduril”, Chris Brose, tha se qëllimi është përdorimi i një grupi të përbashkët mjetesh dhe procesesh prodhimi për të shkallëzuar lehtësisht prodhimin. Kompania për disa kohë ka bërë thirrje në mënyrë madhështore për ‘rinisjen e arsenalit të demokracisë’, duke kujtuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore për të rritur prodhimin në një shkallë të gjerë dhe tha se objekti i ri do të quhet “Arsenal-1”. Kompania ka sugjeruar se mund të mos kalojë shumë kohë përpara se të ecë përpara me një objekt tjetër, “Arsenal-2”, qoftë në SHBA ose jashtë saj. “Anduril” tha se do të mbështetet në modularitetin për të ndërtuar pajisjet shpejt dhe për të shmangur varësinë nga komponentët me porosi. Ai shtoi se “Arsenali çmonton preferencën tradicionale të prodhimit të mbrojtjes për kompleksitetin, duke dizajnuar produkte që janë sa më të thjeshtë që të jetë e mundur, duke eliminuar materialet, pjesët dhe proceset e specializuara të panevojshme”, duke shtuar se rreth 90% e prodhimit në “Arsenal-1” do të mbështetet në

artikuj me burim komercial. Një tjetër synim i kompanisë është të përmbushë porositë me ritëm, duke sinjalizuar se si industria njeh, që gjatë një kohe të shqetësimeve në rritje të sigurisë, klientët ushtarakë janë më pak në gjendje të presin me vite për pajisje.

Nuk janë vetëm hyrjet e reja që po inovojnë për të thjeshtuar prodhimin e pajisjeve për përdoruesit ushtarakë. “Pratt & Whitney” është ndër ata që kanë punuar në prodhimin e shtresave shtesë, i quajtur gjithashtu printim 3D, për t’u bërë më efikas. Njësia RTX thotë se ka qenë në gjendje të zvogëlojë numrin e pjesëve në motorin e saj të vogël turbojet TJ-150, i përdorur në raketa dhe UAV, duke përdorur një proces të quajtur bashkim, pa kompromentuar performancën. Në vend të përdorimit të derdhjes dhe përpunimit të jashtëm, “Pratt & Whitney” thotë se mund ta printojë komponentin në shtëpi. Furnizuesi ka thënë se kursimet e mundshme vetëm në derdhjet dhe formacionet mund të afrohen 1 miliardë dollarë. “Rolls-Royce” po eksploron gjithashtu përdorimin e printimit 3D për disa nga aktivitetet e saj të lidhura me mbrojtjen. Kompania, për shembull, po shikon prodhimin e shtresave shtesë si pjesë e përpjekjes së saj të motorit demonstrues të zhvillimit të shpejtë Orpheus, që synon pjesërisht Iniciativën e Teknologjisë së Sistemit Ajror Luftarak të Ardhsëm të Mbretërisë së Bashkuar. Orpheus, i financuar bashkërisht nga Rolls-Royce dhe Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar, synon të çojë në një familje motorësh të rinj të vegjël për sistemet e fuqisë si raketat e lundrimit dhe platformat autonome të bashkëpunimit, ekuivalenti në Mbretërinë

e Bashkuar i avionëve luftarak bashkëpunues të SHBA-ve. Printimi 3D i metaleve si dhe i plastikës po testohet dhe integrohet gjithnjë e më shumë nga shërbimet e armatosura, si dhe nga industritë e mbrojtjes. Për forcat e armatosura, përdorimi i printerëve 3D mban premtimin e shkurtimit të zinxhirëve të furnizimit dhe rritjes së disponueshmërisë së pajisjeve përmes furnizimit më fleksibël të pjesëve të këmbimit, duke rritur gjithashtu ritmin e përshtatjes dhe inovacionit të pajisjeve. Megjithatë, ndërsa industria dhe forcat e armatosura ndjekin këto teknologji, garantimi i sigurisë kibernetike do të mbetet një fokus kryesor.

Bota po mendon edhe më agresivisht. “Divergent Technologies”, për shembull, sheh një të ardhme ku disa platforma janë bërë 3D. Kompania, e cila tashmë po punon me “General Atomics”, ka plane për të zhvilluar struktura UAV të printuara në 3D dhe po shikon iniciativën “Replicator” të Pentagonit për të prodhuar sisteme në shkallë. “Divergent” mbështeti lëshimin e “General Atomics” në nëntor 2023, të një Advanced Air-Launched Effects nga gjiri i brendshëm i armëve të një Avenger MQ-20. Ukraina, e cila ka bërë përdorim të konsiderueshëm të UAV-ve, ka ndjekur me shpejtësi teknologjitë e printimit 3D për të vendosur sistemet në terren më shpejt dhe në shkallë. Në fund të vitit 2023, vendi filloi operimin e disa UAV-ve të printuara me rreze të gjatë, duke demonstruar dobinë e sistemeve të tilla.

Interesi për fleksibilitet dhe përgjegjshmëri më të madhe nuk është i kufizuar në fushën e pajisjeve ushtarake. Shumë sisteme moderne të armëve varen nga softueri për performancën e tyre,



megjithëse edhe kjo vjen me sfida të shumta. Lockheed Martin F-35 Lightning II, për shembull, është një platformë me softuer intensiv dhe përditësimi i softuerit ka qenë një burim i problemeve me avionin.

Rëndësia gjithnjë në rritje dhe mbështetja në sistemet e bazuara në softuer ishte e dukshme në vendimin e Marsit 2024, nga Komanda Kontraktuese e Ushtrisë Amerikane për t'i dhënë një kontraktori të fokusuar në softuer, “Palantir Technologies”, një kontratë kryesore të integritit të sistemeve prej 178.4 milion USD. “Palantir” do të zhvillojë dhe do të japë Nyjen e Aksesit të Synimeve të Inteligjencës Taktike (TITAN). TITAN synohet të jetë stacioni tokësor i gjeneratës së ardhshme të inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit të ushtrisë amerikane për të përpunuar të dhënat e mbledhura nga sensorët tokësorë, ajror dhe hapësinor dhe për të përdorur mësimin e makinerive. “Palantir” do të mbikëqyrë ekipin që përfshin gjithashtu kontraktorë më tradicionalë si “Northrop Grumman” dhe “L3Harris”.

“Anduril”, një anëtar i ekipit të “Palantir”, ka theksuar gjithashtu se softueri është çelësi për qasjen e tij ndaj prodhimit të mbrojtjes. Ai e përshkroi platformën e tij “Arsenal” si “përcaktim të softuerit” dhe tha se për të gjitha produktet “Anduril” softueri “shërben si një sistem i unifikuar për të integruar fazat e projektimit, zhvillimit dhe prodhimit masiv”.

Kompanitë më tradicionale të mbrojtjes po përqafojnë gjithashtu këtë mentalitet. Në tetor 2024, shefi ekzekutiv i Saab, Micael Johansson tha se “mënyra se si ne zhvillojmë softuerin është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe kjo duhet të transformohet”. Kompania, tha ai, do të përpiqet të kalojë më shumë në një ‘lloj konfigurimi të fabrikës së softuerit’, ku kodi mund të mbështesë programe të ndryshme. Qeveritë po përshtaten gjithashtu për të përqaftuar qasjet e reja për të bërë biznes. Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së, në tetor 2024, përcaktoi masat e zbatimit për Strategjinë Industriale të Mbrojtjes të zbuluar në janar të atij viti, që synonte forcimin e zinxhirit të furnizimit dhe aftësive bazë të prodhimit. Plani i zbatimit më pas i kërkoi departamentit të miratonte “rrugë më fleksibël për të krijuar aftësi të reja në kohën e duhur”. Në disa raste, kjo thjesht kërkon që institucionet që përdorin mjetet e blerjes të krijuara rishtas të lëvizin me ritëm më të madh për prototipimin e shpejtë dhe prodhimin e pajisjeve.

Edhe pse prodhimi i softuerëve dhe shtresave shtesë po bëhen më kritike për pajisjen e forcave të armatosura, shqetësimet më tradicionale nuk janë zhdukur. Në fund të shtatorit, Pentagoni vendosi një Investim 15 milion USD në Aktin e Prodhimit të Mbrojtjes për të forcuar kapacitetin e falsifikimit të rëndë, me përdorim të mundshëm në prodhimin e nëndetësive të klasit “Virginia” dhe “Columbia”, ndoshta shenja më e qartë se konsideratat e epokës industriale mbeten po aq thelbësore për bazën moderne të mbrojtjes-industriale sa shqetësimet e teknologjisë së re.

Shpenzimet globale të mbrojtjes

Shpenzimet globale të mbrojtjes arritën në 2.46 trilion dollarë në 2024, nga 2.24 trilion dollarë në 2023. Rritja në terma realë u rrit në 7.4% në 2024 krahasuar me 6.5% në 2023 dhe 3.5% në 2022.

Si pjesë e PBB-së, shpenzimet globale u rritën nga një mesatare prej 1.59% në 2022 në 1.80% në 2023 dhe 1.94% në 2024.

Midis 2023 dhe 2024, shpenzimet totale ushtarake ruse u rritën me 41.9% në terma realë në 145.9 miliardë dollarë.

Rritja e shpenzimeve evropiane të mbrojtjes u rrit në 11.7% në terma realë në 2024. Rritja reale e konsiderueshme prej 23.2% në buxhetin gjerman, midis 2023 dhe 2024, e bëri atë buxhetin e katërt më të madh të mbrojtjes në botë, ndërsa Polonia u bë e 15-ta shpenzuese më e madhe e mbrojtjes globalisht, nga vendi i 20-të në 2022.



PRINTIMI 3D I METALEVE SI DHE I PLASTIKËS PO TESTOHET DHE INTEGROHET GJITHNJË E MË SHUMË NGA SHËRBIMET E ARMATOSURA, SI DHE NGA INDUSTRITË E MBROJTJES. PËR FORCAT E ARMATOSURA, PËRDORIMI I PRINTERËVE 3D MBAN PREMTIMIN E SHKURTIMIT TË ZINXHIRËVE TË FURNIZIMIT DHE RRITJES SË DISPONUESHMËRISË SË PAJISJEVE PËRMES FURNIZIMIT MË FLEKSIBËL TË PJESËVE TË KËMBIMIT, DUKE RRITUR GJITHASHTU RITMIN E PËRSHTATJES DHE INOVACIONIT TË PAJISJEVE.

Në përgjithësi, shpenzimet rajonale në Evropë ishin më shumë se 50% më të larta në terma nominalë krahasuar me vitin 2014.

Buxheti i mbrojtjes i Kinës u rrit me 7.4% në terma realë, duke tejkaluar mesataren më të gjerë rajonale prej 3.9%, pavarësisht rritjeve të konsiderueshme në buxhetet japoneze dhe indoneziane. Megjithatë, ngritjet më të forta në rajone të tjera nënkuptonin që pjesa e Azisë në shpenzimet globale ra në 21.7% në 2024 nga 25.9% në 2021.

Evropa: Prokurimi i armëve dhe tendencat e mbrojtjes industriale 2024 - Investime më të mëdha në flota të blinduara dhe të mekanizuara

Gjatë operacioneve në Afganistan dhe Irak, forcat e armatosura evropiane hoqën përparësitë e aftësive të blinduara dhe të mekanizuara. Megjithatë, gjatë tre viteve të fundit, shtetet evropiane kanë avancuar planet për të rikapitalizuar flotën e tyre, madje disa kanë shpallur ambicie për të krijuar këto aftësi nga e para. Holanda tërhoqi tanket kryesore të betejës KNDS “Leopard 2A6” (MBT) në 2011, për shkak të shkurtimeve buxhetore. Megjithatë, në fund të vitit 2024, ministria e mbrojtjes e vendit kërkoi miratimin për të blerë deri në 52 “Leopard 2A8” për të krijuar një batalion të blinduar deri në vitin 2030. Në mënyrë më ambicioze, Lituania njoftoi se do të blinte gjithashtu një batalion të “Leopard 2A8”, si dhe dy batalione luftarake të Systemsfantry HBAnds, automjete (IFV) dhe IFV shtesë ARTEC Vilkas me rrota. Italia po kërkon gjithashtu të zgjerojë flotën e saj të blinduar. Një përparësim i mesëm i CIO “Ariete” është duke u zhvilluar, me plane për të dyfishuar numrin e MBT-ve, duke blerë një lloj të dytë. Bisedimet midis KNDS dhe “Leonardo” për të prodhuar një version italian të “Leopard 2A8” dështuan në mesin e vitit 2024. Që atëherë, “Leonardo” ka krijuar një sipërmarrje të përbashkët (JV) me “Rheinmetall” për të ofruar në vend të kësaj KF51 “Panther”. JV do të ofrojë gjithashtu KF41 “Lynx” për programin ambicioz të ushtrisë italiane për të blerë mbi 1000 automjete, një zgjerim i konsiderueshëm i madhësisë së flotës së saj. Blerja nga Polonia e tankeve koreano-jugore dhe amerikane do të pasohet së shpejti nga prodhimi i IFV-së së saj indigjene HSW “Borsuk” me gjurmim, me plane të mëtejshme për të blerë gjithashtu një platformë më të rëndë. Përpjekjet në të gjithë Evropën për të rigjeneruar aftësitë nuk do të jenë të shpejta, megjithatë, me kompanitë që theksojnë vështirësitë në furnizimin e elektronikës dhe çelikut të blinduar dhe kështu në përsheptimin e shpërndarjes së sistemeve te klientët.

Rritja e prodhimit të municioneve në Evropë bën përparim

Shtetet evropiane, kompanitë e mbrojtjes dhe organizatat shumëkombëshe po garojnë për të rritur sa më shpejt kapacitetin mbrojtës-industrial dhe normat e prodhimit. Kjo nxitet nga nevoja për të mbështetur përpjekjet luftarake të Ukrainës dhe për të

përmbushur kërkesat e vetë forcave të armatosura evropiane, duke përfshirë rezervat më të thella të municionit. Përpjekje të veçanta janë bërë në prodhimin e artilerisë dhe municionit, një kategori ku Ukraina ka një nevojë të madhe. “Rheinmetall”, prodhuesi më i madh i tillë në Evropë, ka rritur prodhimin e tij vjetor global të fishekëve të artilerisë 155 mm me një faktor prej dhjetë nga kapaciteti i tij i para 2022, në 700,000 fishekë dhe planifikon të arrijë një milion deri në vitin 2026. Kompania e ka arritur këtë pjesërisht përmes blerjes së kompanisë spanjolle EXPAL2, si dhe pas nënshkrimit të pajisjeve ekzistuese EXPAL3. Prodhues të tjerë, si KNDS franko-gjerman, po investojnë në vende në Belgjikë, Francë dhe Itali për të arritur një normë vjetore prej 100,000 raundesh deri në vitin 2025, e cila do të rritet nga 60,000 në fillim të vitit 2022. Në mënyrë të ngjashme, kompania skandinave “Nammo” dhe nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kanë marrë rritje të prodhimit në BAE të kontratave kombëtare. Megjithatë, një sërë faktorësh pengojnë shpejtësinë me të cilën kjo mund të ndodhë, duke përfshirë konkurrencën për energjinë dhe kimikatet me sektorin tregtar dhe vështirësitë për të marrë miratimin për të ndërtuar fabrika të reja. Ekziston gjithashtu shqetësim për origjinën e disa materialeve, me shtetet evropiane që mbështeten shumë në Kinë për furnizimin me nitrocelulozë, për shembull. Përveç financimit të rritjes së prodhimit nga qeveritë kombëtare, BE-ja ka siguruar gjithashtu fonde për të rritur ofertën, veçanërisht përmes Aktit të tij të vitit 2023 në Mbështetjen e Prodhimit të Municioneve, i cili ndau fonde për të mbështetur rritjen industriale dhe prodhimin e sektorit të municioneve dhe raketave. BE synon që kapaciteti total vjetor i prodhimit të vendeve anëtare të arrijë në dy milionë raunde deri në fund të vitit 2025.

Shtetet evropiane diversifikojnë furnitorët

Që kur filloi pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia, në shkurt 2022, shtetet evropiane i kanë përsheptuar përpjekjet e tyre për modernizimin. Kjo ka krijuar mundësi për kompanitë jashtë Evropës, si dhe furnizuesit tradicionalë amerikanë, të cilët ose mund të furnizojnë pajisje më shpejt se konkurrentët e tyre evropianë ose të prodhojnë pajisje që pak ose asnjë kompani evropiane aktualisht nuk mundet, si p.sh. raketahedhës të shumëfishtë (MRL). Nga shkurti 2022 deri në fund të tetorit 2024, kompanitë koreano-jugore siguruan kontrata prodhimi me vlerë 18.03 miliardë dollarë nga shtetet evropiane. Pjesa dërrmuese e kësaj shume, 16.88 miliardë dollarë, është kontraktuar nga Polonia, e cila po kërkon të modernizojë dhe zgjerojë me shpejtësi madhësinë e forcave të saj të armatosura. Kjo përfshin blerjen e një numri të madh të gjurmuesve “Hanwha K9 Thunder”, të porositura ose të operuara tani nga shtatë vende evropiane. Firmat izraelite gjithashtu kanë gëzuar sukses, duke nënshkruar kontrata me vlerë 6.85 miliardë USD+, gjatë kësaj periudhe kohore. Megjithëse shitja e sistemit të mbrojtjes balistike të raketave IAI “Arrow 3” Gjermanisë (3.89 miliardë dollarë) përbën pjesën më të madhe të kësaj, ajo përfshin gjithashtu shitjen e MRL-ve të “Elbit Systems” PULS në Danimarkë, Holandë dhe Spanjë. Në mënyrë të ngjashme, që nga viti 2019, “Embraer” i Brazilit ka nënshkruar kontrata me pesë shtete evropiane për transportuesin e saj të mesëm ajror KC-390: me një vlerë totale prej 4.18 miliardë dollarësh, nga të cilat 2.96 miliardë dollarë kanë ardhur që nga shkurti i vitit 2022. Disa politikanë dhe industrialistë në Evropë kanë kritikuar blerje të tilla, duke argumentuar se duhet të ndërtojë një shtet tjetër për të krijuar sisteme pune nga një shtet tjetër evropian. Megjithatë, vendet e tjera, ndërkohë që mbështesin ambicien e përgjithshme në terma afatgjatë, kanë preferuar të blejnë sisteme jo-evropiane për të arritur objektivat e aftësive më shpejt.



EKZISTON GJITHASHTU NJË NJOHJE MIDIS DISA QARQEVE TË LARTA USHTARAKE DHE POLITIKE SE MODELET E VJETRA TË BLERJES DHE PRODHIMIT TË MBROJTJES NUK JANË MË PLOTËSISHT TË PËRSHTATSHME PËR QËLLIMIN. BAZA EKZISTUESE E MBROJTJES-INDUSTRIALE PO ORIENTOHEK MË SHUMË DREJT NJË BAZE LUFTE, NDËRSA LOJTARËT NË ZHVILLIM INKURAJOHEN TË OFROJNË PËRGJIGJE TË NDRYSHME DHE MË TË SHPEJTA PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT MATERIALE TË MBROJTJES.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në përkujtim të dëshmorit të Policisë së Shtetit shqiptar, Sali Xhevair Shehu (29.1.1951 – 18.7.2002)

Rreth origjinës të trungut familjar të Sali Shehut... në kërthizë të fshatit Fushëbardhë!

Fushëbardha është fshati i shquar në historinë e krahinës, dhe përtej saj në Labëri. Bijtë dhe bijat e lindur këtu kanë jetuar me nder e dinjitet dhe u kanë dalë halleve e dertëve përpara në çdo kohë dhe në çdo situatë. Shehajt e Fushëbardhës janë njerëz të thjeshtë dhe të mençur, luftëtarë kur e ka lypur nevoja historike e vendit dhe punëtorë dinjitozë që punonin pa bujë, por me dinjitet, ndershmëri dhe plot njerëzillëk, të respektuar në vendlindje dhe përtej saj. Sali Shehu ishte lindur, më 29 janar 1951, në Fushëbardhë të Gjirokastrës, në një familje me tradita atdhetare dhe patriotike. Sali Shehu ishte djali i Xhevair Shehut dhe Tahire Serjan Shehu (Muho), njerëz të thjeshtë, të dashur e të respektuar, jo vetëm në fshat por edhe në krahinë. Saliu erdhi në jetë në një ambjent patriotik dhe atdhetar, në një familje emblemë mirësie, me rrënjë të thella mençurie.

Rrënjët e fisit fushëbardhas “Shehu/Xhuvani/Poçi”, shtrihen thellë në historinë e fshatit Fushëbardhë, por që janë të njohur jo vetëm në Fushëbardhë por në mbarë krahinën e Kardhiqit si dhe krahinën e Rrëzomës. Sali Shehu i parë, i cili ishte klerik i Fushëbardhës dhe njihej “Sheh Sali Shehu”, një titull nderi i dekretuar/i trashëguar në rrugë shpirtërore në shërbim të njerëzve. Në themelet e Sheh Saliut të viteve 1800, ishte deviza “Atdheu dhe Feja”, udhëheqësja morale, fetare, atdhetare e patriotike. Sali Shehu ka qenë dikur Shehu klerik i Fushëbardhës, që i përket rreth viteve 1800. Ai ka qenë i shkolluar në shkollat fetare të kohës por edhe kishte mbaruar shkollën në vendet arabe për edukim fetar/medrese/Ruzhdie si dhe njihte pesë gjuhë të huaja bashkë me gjuhën e nënës. Ishte periudha kur Sheh Saliu e ktheu mbiemrin nga Xhuvani në Shehu, një llagap 225 vjeçar. Shtëpia-teqe ka qenë dykatëshe në qendër të fshatit, vetëm pak metra larg rrapit shekullor. Sali Shehu i parë ishte një mal diturie për Fushëbardhën dhe krahinat këtej dhe matanë qafës së Skërficës. Nga ai mësonin shumë njerëz dhe dëgjohej me vëmendje për këshillat me vlerë. Nga ana tjetër në të gjitha aktivitetet luftarakë Shehajt janë shquar në historikun e fshatit Fushëbardhë në luftërat për mbrojtjen e Vilajetit të Janinës dhe mbarë truallit arbëror në jug të vendit, më 1913-1914, në periudhën e luftës dhe përbaljes me andartët grekë, librat dhe reliket e trashëguara të Shehut të parë i mblodhën dhe i futën në qypa dhe i fshehën në bodrumet, kështu edhe biblioteka dhe shënimet e Shehut, por që u gjendën nga andartët u plaçkitën dhe u dogjën, duke djegur kështu një copëz të mirë të historisë së Fushëbardhës. Në Fushëbardhë dhe fshatrat përreth kanë mbetur në kujtesën kolektive ditët e ashures dhe festave fetare, që organizonte Shehu i fshatit dhe që shndërroheshin si ditë dasmash e bollëku, ku komunitetin e përbashkonte mençuria, urtësia, dijet e thella të një njeriu të ditur që ushqeu dituri e dritë në komunitetin njerëzor të Fushëbardhës. Në vitet që pasuan, Zano Shehu ka qenë pjesë e luftëtarëve të çetës së Fushëbardhës që kënga thotë: “Merri Vlorë bijtë tanë./78 jataganë..”, që luftuan për çlirimin e Vlorës, por dhe përgjatë Luftës Antifashiste ka qenë edhe pjesë e batalionit territorial që u krijua, më 13.4.1943, në Cepo të fshatit Plesatit. Gjyshi i Sali Shehut, Zano Shehu luftonte krah trimave Karafil Bello Nexhip/Xhipe Kozaku, dhe 72 bashkëluftëtarëve të tjerë nga Fushëbardha por dhe dhjetëra e dhjetëra trimave të të gjithë krahinës së Kardhiqit, që shkruan faqe lavdie në kohë pushtimi. Oxhaku Shehu përgjatë LANÇ-it ka edhe një figurë tjetër të shquar, të nderuar e respektuar përjetësisht: Alem Zano Shehu (5.6.1920 -15.4.1944), një luftëtar trim të rreshtave partizane që e derdhi gjakun për lirinë e Shqipërisë dhe ka merituar përjetësinë, pasi është nderuar me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut” me Vendim nr.65 datë 2.10.1971 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë. Në rrugën e nderit dhe respektit për veprimtarinë e të parëve ecën edhe fëmijët e Xhevairit dhe të Tahiresë, Saliu, Gjylua, Elda, Sheremeti dhe Perlati. Si gjithë bashkëmoshatarët e tjerë e ngritën jetën me djersë, përpjekje e mundim për të mbajtur lart ndjenjën atdhetare të të parëve, duke respektuar gjakun e të rënëve dhe duke u bërë të vlefshëm, të nderuar dhe të respektuar për shoqërinë.

Në rrugën e shkollimit, formimit dhe konsolidimit profesional

Në periudhën kur erdhi në jetë Sali Shehu në fshatin e tij të lindjes kishte vetëm shkollë fillore, një shkollë e trashëguar që prej fillim-shekullit të kaluar kur Nexhip efendi Çarçani dhe dervish Mehmet Golemi, që e mbështeste, hapën dritën e parë të diturisë në Fushëbardhë, në vjeshtën e vitit 1907. Regjimet që erdhën më pas: Pavarësia, luftërat, Republika e parë, Mbretëria e parë dhe Lufta e Dytë Botërore e lanë Fushëbardhën për periudhën 1907-1971 vetëm me një shkollë të thjeshtë fillore. Djemve dhe vajzave të Fushëbardhës, sikurse edhe Sali Shehu, u takonte që shkollën shtatëvjeçare ta bënin në Zhulat, duke e kaluar qafën e Bardhë dy herë në ditë, në borë, breshër, shi, dhe diell përvëlues në të gjitha kushtet e motit. Sali Shehu pasi kreu me sukses të plotë arsimin shtatëvjeçar në fshatin Zhulat, ka vijuar shkollën e mesme “Gjeologji-Miniera”, në qytetin e Përrenjasit, në periudhën 1971-1975. Më pas kreu stazhin e shkollës së mesme, duke punuar në minierë në galeri, gjatë viteve 1975-1976, ku mori vlerësime të mira nga drejtuesit e ndërmarrjes gjeologjike, që shërbente me përkushtim. Saliu iu përgjigj thirrjes për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak dyvjeçar, 1976-1978, të cilin e ka kryer në Gardën e Republikës,

SALI SHEHU, HEROIZMI QË JETON NË ZEMRËN E ATDHEUT



Sali Shehu, Dëshmor i Atdheut

në specialitetin “radiotelegrafist”. Specialitetin e radiotelegrafistit e mësoi menjëherë pas kryerjes së “karantinës” tre mujore të shërbimit ushtarak. Detyrën e ka kryer me përpikëri në strukturën elitare të Gardës së Republikës, ku është vlerësuar edhe me fletë-lavdërimi, iu kërkua të shërbente në radhët e Forcave të Armatosura, por për arsye familjare vendosi të mos vijonte shërbimin nën armë në shërbimin e ndërlidhjes, por të kthehej në vendlindje. Ishte koha kur nuk kishte shumë zgjedhje dhe zgjidhjet në jetë duhet t’i jepje vetë, me aftësi dhe shumë sakrificë.

Jeta në Polici, sakrificë dhe përkushtim ndaj detyrës

Kryerja e funksioneve në Polici, por edhe në funksione të tjera në forcat e armatosura, ka qenë dhe ka ngelur nga më të vështirat, për vetë natyrën e punës. Ishte koha kur Shqipëria kishte dhe ka vetëm një shkollë policie, në Sauk të Tiranës, ndërkohë që për kohën quhej shkolla e MPB-së, që përveç përgatitjes së studentëve në sistemin trevjeçar me shkëputje nga puna për profilet: Polici, Sigurim dhe Kufi, përgatiste edhe kurset praktikë për nënoficerë, policë dhe ushtarë. Ishte koha kur policia popullore shqiptare kishte një kontingjent njerëzish të kualifikuar dhe të kufizuar, përfshi këtu edhe “batalionin e gatishmërisë së policisë popullore”, ose Reparti 326, me oficerë, nënoficerë, policë dhe ushtarë. Gjithë kontingjentet përgatiteshin në shkollën e Saukut, megjithëse në këtë periudhë, kur Sali Shehu do të përfshihej në strukturat e policimit, limiti organik i Policisë së Shtetit shqiptar ka qenë rreth 3700 punonjës policie. Në këtë kontingjent ishte si të thuash një “privilegj”, pasi më shumë ishte përgjegjësi që të punoje në polici. Kështu Sali Shehu pas kryerjes së formaliteteve, por dhe për shkak të biografisë që ishte element parësor deciziv për kohën, më datën 23 janar 1978, u pranua në funksionin polic i shërbimit aktiv në Degën e Punëve të Brendshme të Gjirokastrës. Në periudhën mars deri në maj 1978, kreu kursin 3-mujor të policisë për aftësim në kryerjen e detyrës së shërbimit të rojës dhe të patrullës, ndërsa në periudhën tetor 1979-korrik 1980, ka kryer me rezultate të larta kursin 9 mujor të punëtorit të policisë; në shtator 1981, titullohet nënoficer aktiv, në vitin 1984, iu miratua kërkesa e vijimit pa shërbyer katër vitet e para në detyrën “punëtor i policisë” në Zagori dhe më vonë ishte “komandant i postës” në radiostacionin e fshatit Bullo në Dropull. Në qershor të vitit 1992, kur sapo kishte fryrë era demokratike edhe në Shqipëri dhe kishte ardhur “pushteti pluralist” caktohet “komandant i postës së policisë” në Libohovë, në mars 1993, riemërohet “komandant i postës” në Libohovë, dhe në tetor 1996, transferohet në pikën e kalimit kufitar në Kakavijë. Pas tre vitesh në Kakavijë, në vitin 1999, kalon në postën e policisë së fshatit të Vriserasë, më pas edhe në fshatin Suhë në këtë “karakoll të krahinës”. Në vijimësi kryen detyrën si “polic rendi”, në dhomat e izolimit në Gjirokastrë, e më pas edhe në detyrën “referent i zbatimit të vendimeve penale”, pak kohë shërbeu në detyrën “nënoficer roje” në sektorin e armatimit. Në qershor 2000, rikthehet në detyrën “inspektor i policisë së rendit” në Kardhiq, në vitin 2001, kreu këtë detyrë në Lunxhëri, në Antigone dhe fshatin “Asim Zeneli” si dhe në fshatin Llongo. Sali Shehu ka shërbyer me dinjitet në strukturat e Policisë së Shtetit për 24 vite e 6 muaj. Vlerësimet e punës i ka pasur shumë të mira, duke evidentuar se “...ka aftësi të mira profesionale, ka përballuar me sukses të gjitha detyrat që i janë ngarkuar, i vëmendshëm dhe korrekt në detyrë, ka pasion dhe vullnet në punë, ndjek me kujdes të gjitha problemet që lidhen me përmbushjen e detyrave nga ana e tij në pikëpamje profesionale, i papajtueshëm me shkelësit e ligjit, i aftë fizikisht, ka krijuar marrëdhënie të mira në komunitet, sillet mirë me shokët, respekton eprorët..., etj.”. Të gjitha këto e kishin bërë Sali Shehun, një imazh të njeriut me vlera dhe virtyte pozitive gjithmonë në ballë të punëve dhe me përkushtim ndaj detyrave. Rënia aksidentale në krye të detyrës e Sali Shehut dhe shokëve të tij ka qenë aksidentalisht më datë 18.7.2002, kur ishte në detyrën “inspektor i policisë së rendit” në Llongo. Rrethanat e humbjes së jetës së Sali Shehut dhe shokëve të tij, përshkruhen në vërtetimin e prokurorisë së rrethit Gjirokastrë, që mban datën 20.7.2002, (dy ditë pas ngjarjes fatale), ka filluar procedimin penal nr.114, për

veprën penale që bën fjalë për ngjarjen e datës 18.7.2002, ndodhur në superstradën Kakavijë-Gjirokastrë dhe konkretisht në afërsi të kthesës së fshatit Jorgucat, ku u përplasen autovetura tip “Golf” me targë “GJ5664-A”, me autobusin tip “Bova”, me targë greke “YZO-7444” dhe për pasojë mbeten të vdekur tre punonjësit e policisë që ndodheshin në autoveturën tip “Golf”, konkretisht: Sali Shehu, Altin Dauti, Zaçe Biraçi. Nga verifikimet konkrete të kryera nga ekspertë ka rezultuar se tre punonjësit e policisë, efektivë të komisariatit të policisë Gjirokastrë, punonjës shërbimi në postën kufitare Llongo, ishin urdhëruar nga zëvendësudrejtori i Policisë së qarkut Gjirokastrë dhe shefi i Policisë Kufitare për të organizuar shërbim në superstradën nacionale Kakavijë-Gjirokastrë. Ishte një ditë fatale, pasi në kthesën e fshatit Jorgucat, në rrugën që shkon për Sarandë, duke realizuar bllokim në hyrje të fshatit Jorgucat, mbasi në drejtim të tyre do të kalonte një makinë me klandestinë, me synim kalimin në territorin grek në mënyrë të paligjshme dhe pranë vendit do të sistemoheshin tre efektivët e policisë të komisariatit të policisë Gjirokastrë për të organizuar shërbimin atje, ku në fakt ndodhi edhe aksidenti tejet i rëndë dhe me pasoja të rënda për punonjësit e Policisë së Shtetit. Rreth dy muaj pas ndodhjes së ngjarjes më 7.10.2002, Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Gjirokastrë, vendosi pushimin e procedimit penal nr.114, të filluar më datën 20.07.2002, duke arsyetuar se, “i pandehuri Gëzim Dulla, shofer i autobusit të linjës Tiranë-Athinë ka udhëtuar pa asnjë problem deri në afërsi të fshatit Jorgucat, kur në afërsi të kthesës së rrugës që shkon për Sarandë, i ka dalë përpara një autoveturë në ngjyrë të verdhë që po kthehej nga Saranda, tip “Golf”, i cili është futur në autostradë. Shoferi i autobusit ka devijuar autobusin nga krahu i majtë të drejtimit të lëvizjes Gjirokastrë-Kakavijë, ndërsa goma e pasme e autobusit, nga krahu i shoferit ka dalë në karaxhatë, kurse autovetura është futur poshtë autobusit... Autovetura drejtohej nga polici Sali Shehu, i cili kishte mjetin në pronësi të tij”. Në vijim, prokuroria ka konkluduar se në vlerësim të materialeve që ndodhen në dosjen hetimore provohet se, “fakti nuk ekziston që nga ana e drejtuesit të automjetit të të pandehurit Gëzim Dulla të kemi shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, prandaj ka vendosur pushimin e çështjes penale”. Por ngjarja në Jorgucat të Gjirokastrës ishte një ngjarje e dhimbshme jo vetëm për familjarët, por për mbarë organizatën e Policisë së Shtetit. Ngjarja për humbjen e policit shembullor e korrekt Sali Shehut u përcoll me dhimbje, brengë e trishtim në Fushëbardhën e tij të lindjes, nga familjarët e dashur, miqtë e dashamirësit, tek kolegët e policisë në Gjirokastrë e më gjerë.

Sfidat e një jetë plot përkushtim... si dhe përjetësisht në kujtimin e brezave

Sali Shehu u martua, më 24.12.1978, me znj. Silvana Hajrulla Shehu (Veliu) po nga fshati Fushëbardhë, me të cilën lindën tre djem, por fatkeqësisht një nga djemtë, Eltoni u nda nga jeta në moshë fare të re, 18-vjeçare, pasi lindi i sëmurë dhe nuk mundi të ecte në këmbë. Megjithatë Saliu dhe Silvana sollën në jetë edhe dy djem të tjerë Ermirin dhe Lisianin. Djali, Ermiri, ka qenë i vetëpunësuar në Tiranë dhe aktualisht punon e jeton në Britani të Madhe, në një depo farmaceutike. Ermiri është i martuar me Sabina Tafa nga Tirana dhe kanë një djalë, Santion. Ndërsa Lisiani, ka emigruar në Greqi, ku ka kryer edhe studimet universitare për fizioterapist dhe aktualisht ushtron profesionin e fizioterapistit në shtetin fqinj, në Athinë. Lisiani është i martuar me Nicol Vassalou, shtetase greke dhe janë në pritje të një fëmije. Familjarët, miqtë e shokët, e kujtojnë Sali Shehun si një njeri me vlera e virtyte të rralla njerëzore, i cili arriti t’iu përcjellë fëmijëve që në moshë të vogël parimin e ndershmërisë dhe sinqeritetit, si dhe dashurinë për punën, duke ecur kështu në rrugën e të parëve të oxhakut familjar. Bashkëmoshatarët e tij e vlerësonin qetësinë dhe maturinë, por edhe përmbajtshmërinë e tij në zgjidhjen e problemeve dhe halleve të kohës. Një familjar i kujdesshëm, i dashur dhe i qetë, që nuk shprehu kurrë mërzitje për fatkeqësinë që kishim me djalin e sëmurë, përkundrazi ishte shumë i kujdesshëm për mirëritjen e tij. Në vlerësimet e njerëzve ka qenë gjithmonë i respektuar në shoqëri, në kolektivin e punës. Sali Shehu ishte pjesë vitale e gjakut të njerëzve të rendit dhe sigurisë publike, që sakrifikojnë për detyrën si shtetar i devotshëm, gjithmonë në shërbim të njerëzve. Në atë mes-korriku të nxehtë të vitit 2002, Sali Shehu u përcoll me nderimet më të larta në banesën e fundit si bashku me Altin Petrit Dautin dhe Zaçe Qerim Biraçin nga Picari. Eshtrat e tyre prehen në varrezat publike të Gjirokastrës, edhe pse kanë varret simbolike në Varrezat e dëshmorëve të Atdheut të Gjirokastrës dhe që meritojnë të ripërcillen konform ligjit nr. 109/2018 datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 13 “Vendprehja e dëshmorëve të atdheut” pika 3 thotë, “Çdo dëshmor ka një varr në varrezat e dëshmorëve të atdheut, të ngritur në territorin e qarkut ku ka rënë ose ka pasur vendbanimin...” dhe pika 5 “Varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut në qarqet përkatëse bëhet me vendim të këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose të prefektit” dhe pika 11, “Shpenzimet e varrimit të dëshmorëve të atdheut ose të rivarrimit të mbetjeve të tyre mortore të përballohen dhe të parashikohen nga buxheti i shtetit”. Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me vendim nr. 56, datë 17.6.2005, e ka shpallur Sali Xhevair Shehun (1951-2002) “Dëshmor të Atdheut”, ndërsa familjes i ka dhënë simbolin “Familje e Dëshmorit të Atdheut”. Për organizatën e Policisë së Shtetit, që është misionare e përhershme e mbrojtjes edhe me jetë e rendit dhe sigurisë publike shqiptare, për ata që jetën e njerëzve e mbrojnë përditë me jetën e tyre, mirënjohja është e pakufishme mbarë-popullore, mirënjohje e respekt që është për dëshmorin e Policisë Sali Shehu dhe për gjithë dëshmorët e tjerë të Policisë së Shtetit.

“E Premtja e Zezë”, e 7 prillit 1939

Pushtimi italian i Shqipërisë, edhe pse formalisht ekzistonte si protektoriat i Mbretërisë së Italisë, de jure ishte një bashkim midis Italisë dhe Shqipërisë, i udhëhequr zyrtarisht nga Mbreti Victor Emmanuel III, de facto ishte një pushtim që zgjati nga 1939 në 1943. Shqipëria u udhëhoq nga guvernatorët italianë, pasi u pushtua ushtarakisht nga Italia, nga viti 1939 deri më 1943. Gjatë kësaj kohe Shqipëria pushoi së ekzistuari si një vend i pavarur dhe mbeti si një pjesë autonome e Perandorisë Italiane të drejtuar nga zyrtarë të qeverisë italiane, të cilët synonin ta bënin Shqipërinë pjesë të një Italie të Madhe, duke asimiluar shqiptarët si italianë dhe duke kolonizuar Shqipërinë me kolonët italianë nga Gadishulli Apenin për ta transformuar gradualisht në një Tokë italiane. Ndaj erdhi 7 prilli i vitit 1939, dita e pushtimit nga ushtria fashiste italiane.

7 prilli i 1939, e gjente popullin shqiptar në një gjendje të mjerë ekonomike, në një gjendje të turbullt ishte edhe rinia shqiptare, pikërisht në pragun e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Shtatë prilli 1939, mbylli një faqe dhe hapi një tjetër. Ndërsa para pushtimit fashist, regjimi monarkik e kishte lidhur shtetin shqiptar mbrapa rrotave të Italisë, me marrëveshjet e nënshkruara, që pasonin njëra-tjetrën, duke u bërë shkaktar mund të thuhet, që t’i hapeshin dyert pushtimit të huaj, duke humbur krejt lirinë e pavarësinë dhe u bë fushë e lirë, ku pastaj zuri vend propaganda komuniste. Pushtimi italian i Shqipërisë (7-12 prill 1939) ishte një fushatë e shkurtër ushtarake nga Mbretëria e Italisë kundër Mbretërisë së Shqipërisë. Konflikti ishte rezultat i politikave imperialiste të diktatorit italian Benito Musolini. Shqipëria u kapërdi shpejt, Mbreti Zog I u detyrua të largohet dhe vendi u bë pjesë e Perandorisë Italiane si një mbretëri e veçantë në bashkimin personal me kurorën italiane.



Strategjia italiane e pushtimit fashist

Shqipëria kishte kohë që kishte një rëndësi të konsiderueshme strategjike për Mbretërinë e Italisë. Strategjitë detare italiane lakmuan portin e Vlorës dhe ishullin e Sazanit në hyrje të Gjirit të Vlorës, pasi ata do t’i jepnin Italisë kontrollin e hyrjes në detin Adriatik. Në periudhën e vonshme osmane lëvizja nacionaliste shqiptare fitoi mbështetjen e fortë të dy fuqive detare Adriatik-Hungari dhe Itali, të cilët ishin të shqetësuar për pan-sllavizmin në Ballkan e më gjerë dhe hegjemoninë anglo-franceze, që supozohet të përfaqësohej përmes Greqisë në rajon. Para Luftës së Parë Botërore Italia dhe Austro-Hungaria kishin mbështetur krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, Italia kishte kapur shansin për të pushtuar gjysmën jugore të Shqipërisë, për të shmangur pushtimin e saj nga austro-hungarezët. Ky sukses nuk zgjati shumë, pasi rezistenca shqiptare gjatë Luftës së Vlorës, bashkë me problemet e brendshme të pasluftës e detyroi Italinë të largohej në vitin 1920. Dëshira për të kompensuar këtë dështim do të ishte një nga motivet kryesore të Musolinit në pushtimin e Shqipërisë. Dhe gjithçka filloi nën shenjë e ndihmave që një shtet i jepte një shteti të vogël, të prapambetur e të pambrojtur. Filloi më 1925 me marrëveshjen për ngritjen e Bankës Kombëtare, e cila ra menjëherë e plotësisht në dorë të italianëve, duke grumbulluar atë sasi ari, që mbeti mollë sherri për disa dekada. Vijoi pastaj me monopolin italian mbi peshkimin, me pretendimet për të shtënë në dorë tokat bujqësore, me huanë e Sveas e hua të tjera, me paktin e Tiranës të 1933-shit, me kërkesën për lidhjet doganore dhe për kontrollin e plotë mbi ushtrinë e financat, për formimin e partisë fashiste shqiptare e, së fundi, për vendosjen e kolonëve italianë në tokat bujqësore. Arsyetohej: “Në Italinë e Jugut kemi strehuar disa qindra-mijëra shqiptarë. Përse të mos ngjasë kjo edhe në anën tjetër të Adriatikut?”. Nëse bëhet kjo pyetje, si të mos mendojmë se numri i shqiptarëve që strehohen sot në Itali është ku e ku më i madh sesa në orën e zezë, kur u vendos pushtimi fashist. Gjithçka, pra, nën maskën e ndihmës, të bashkëpunimit, të miqësisë, deri sa Shqipëria të mos ishte më në gjendje t’i paguante huat e të shitej në tregun e pengjeve, të bëhej krahinë e Italisë. E historia e ndihmave, e huave, e miqësive të përrjetshme, e lidhjeve si mishi me kockën, e mbrojtjes nga Shteti i madh në emër të zhvillimit, do të përsëritej tragjikisht në trojet e Shqipërisë e cila, e tradhtuar nga fqinjët, do të shkonte në kërkim të miqve të fuqishëm tepër larg e tepër të dëmshëm, deri në skajet e Lindjes së Kuqe e më tutje.

Në agimin e 7 prillit 1939, banorët e Tiranës i zgjoi gjëmimi i artilerisë. Këtë herë ishin bateritë e luftanijeve italiane, që po bombardonin Durrësin në përgatitje të zbarkimit. Asnjë skrupull moral, asnjë respekt për një popull të vogël të shpallur mik, për



fjalën e dhënë, për traktatet e nënshkruara! Ushtima e topave ishte kob, por edhe sihariq: pushtuesi kishte ndeshur rezistencë, nuk ishte pritur me lule. Populli shqiptar nuk e kishte humbur tiparin themelor, pa të cilën do të përpihej në gjiret e kombeve të mëdha: dëshirën e zjarrtë për liri! E këtë duhet ta merrte vesh mirë bota. Përndryshe e për fat të keq, do të na duhej ta formulonim mesazhin e kësaj dite me një shprehje të vetë Musolinit: “Nuk e meriton lirinë një popull, që nuk është gati të vdesë për të!”. Planet origjinale italiane për pushtimin kërkuan deri në 50,000 njerëz të mbështetur nga 51 njësi detare dhe 400 aeroplanë. Në fund të fundit forca e pushtimit u rrit në 100,000 njerëz të mbështetur nga 600 aeroplanë, por vetëm 22,000 morën pjesë në pushtim. Më 7 prill, trupat e Musolinit, të udhëhequr nga gjeneral Alfredo Guzzoni, pushtuan Shqipërinë, duke sulmuar të gjitha portet shqiptare njëkohësisht. Forcat detare italiane të përfshira në pushtim përbëheshin nga anijet luftarake “Giulio Cesare” dhe “Conte di Cavour”, tre kryqëzorë të rëndë, tre kryqëzorë të lehtë, nëntë destroyerë, katërmbëdhjetë anije silurë, një minakërkuese, dhjetë anije ndihmëse dhe nëntë anije transporti. Anijet u ndanë në katër grupe, që kryen zbarkime në Vlorë, Durrës, Sarandë dhe Shëngjin. Nga ana tjetër, ushtria e rregullt shqiptare kishte 15,000 trupa të pajisura keq, të cilët ishin trajnuar nga oficerë italianë. Plani i Mbretit Zog ishte të ngrinte një rezistencë në male, duke lënë portet dhe qytetet kryesore të pambrojtura; por agjentët italianë të vendosur në Shqipëri si instruktorë ushtarakë e sabotuan këtë plan. Shqiptarët zbuluan se topat e artilerisë nuk funksionin dhe nuk kishte municion. Si pasojë, rezistenca kryesore u ofrua nga xhandarët dhe grupet e vogla të patriotëve. Në Durrës, një forcë prej 500 shqiptarësh, përfshirë xhandarët dhe vullnetarët e armatosur, të udhëhequr nga Major Abaz Kupi (komandanti i xhandarmërisë në Durrës) dhe Mujo Ulqinaku, një rreshter detar, u përpoqën të ndalonin përparimin italian. Pajisur me armë të vogla dhe tri mitralozë dhe të mbështetur nga një bateri bregdetare. Mbrojtësit rezistuan për disa orë para se të asgjësoheshin me ndihmën e artilerisë detare. Marina shqiptare e vendosur në Durrës përbëhej nga katër anije patrullimi (secila e armatosur me mitraloz) dhe një bateri bregdetare me katër armë 75 mm, të cilët gjithashtu ishin përfshirë në luftime. Mujo Ulqinaku, komandanti i anijes patrulluese “Tirana”, përdori armatimet e tij për të vranë dhe plagosur shumë trupa italiane, derisa u vra nga një predhë e artilerisë nga një anije luftarake italiane. Përfundimisht, një numër i madh i tankeve të vogla u shkarkuan nga anijet italiane. Pas kësaj, rezistenca filloi të shpërthente, dhe brenda pesë orësh italianët e kishin kapur qytetin. Deri në orën 13:30 në ditën e parë, të gjitha portet shqiptare ishin në duart e Italisë. Po atë ditë mbreti Zog, bashkëshortja e tij, mbretëresha Geraldine Apponyi dhe djali i tyre i mitur Leka, u arratisën në Greqi, duke marrë me vete një pjesë të rezervave të arit të Bankës Qendrore Shqiptare. Kur dëgjoi lajmin, një turmë e zemëruar sulmoi burgjet, lironi të burgosurit dhe shkarkoi largimin e Mbretit. Në 9:30 të mëngjesit, më 8 prill, trupat italiane hynë në Tiranë dhe shpejt kapën të gjitha ndërtesat qeveritare. Kolonat italiane të ushtarëve pastaj marshuan në Shkodër, Fier dhe Elbasan. Shkodra u dorëzua në mbrëmje pas 12 orëve të luftimeve. Megjithatë, dy oficerë të garnizonit në



këshqjellën e Rozafës refuzuan t’i bindeshin rendit të armëpushimit dhe vazhduan të luftonin derisa iu mbaruan municionet. Trupat italiane më vonë iu bënë homazh trupave shqiptare në Shkodër, të cilët kishin ndalur përparimin e tyre për një ditë të tërë. Gjatë avancimit italian në Shkodër turma rrethoi burgun dhe çliroi rreth 200 të burgosur.

Numri i viktimave në këto beteja është i diskutueshëm. Burime italiane pohojnë se në Durrës, 25 italianë u vranë dhe 97 u plagosën dhe 160 shqiptarë u vranë dhe disa qindra të plagosur, (sqarimi i nevojshëm, deklaroi se rreth 400 italianë ishin vranë). Më 12 prill, parlamenti shqiptar votoi për ta zhvendosur Zogun dhe për të bashkuar kombin me Italinë “në bashkim personal”, duke ofruar kurorën shqiptare Mbretit italian, Viktor Emmanuel III. Parlamenti zgjodhi pronarin më të madh të Shqipërisë, Shefqet Vërlaci, si Kryeministër. Vërlaci shërbeu si kreu i përkohshëm i shtetit për pesë ditë derisa Viktor Emmanuel III zyrtarisht pranoi kurorën shqiptare në një ceremoni në pallatin e Quirinale në Romë.

Viktor Emmanuel III emëroi Francesco Jacomoni di San Savino, ish-ambasador në Shqipëri, për ta përfaqësuar në Shqipëri si “Gjenerallejtënant i Mbretit”. Suksesi relativisht i lehtë i pushtimit italian ishte kryesisht për shkak të rezistencës së dobët shqiptare.

Momenti kritik

Më 15 prill 1939, Shqipëria u tërhoq nga Lidhja e Kombeve, nga e cila Italia dha dorëheqjen më 1937. Më 3 qershor 1939, ministria e jashtme e Shqipërisë u fut në ministrinë e jashtme italiane dhe ministrit të Jashtëm shqiptar, Xhemil Dinos iu dha rang i ambasadorit italian në Shqipëri. Pas kapjes së Shqipërisë, diktatori italian Benito Mussolini shpalli krijimin zyrtar të Perandorisë Italiane dhe mbreti Victor Emanuel III u kurorëzua mbreti i shqiptarëve, përveç titullit të tij të perandorit të Etiopisë, i cili ishte pushtuar tre vjet më parë. Ushtria shqiptare u vendos nën komandën italiane dhe u bashkua formalisht në Ushtrinë Italiane në vitin 1940. Përveç kësaj, Bluzat e zeza italiane formuan katër legjione të Milicisë Shqiptare, fillimisht të rekrutuar nga kolonistët italianë që jetonin në Shqipëri, por më vonë nga shqiptarët etnikë. Pas pushtimit të Shqipërisë dhe instalimit të një qeverie të re, ekonomitë e Shqipërisë dhe të Italisë u lidhën nëpërmjet një bashkimi doganor, që rezultoi me heqjen e shumicës së kufizimeve tregtare. Përmes një bashkimi tarifor, sistemi italian i tarifave u vendos në Shqipëri. Për shkak të humbjeve të pritshme ekonomike në Shqipëri nga ndryshimi i politikës tarifore, qeveria italiane i dha Shqipërisë 15 milionë lekë në vit për kompensim. Ligjet doganore italiane do të aplikoheshin në Shqipëri dhe vetëm Italia mund të lidhte traktate me palë të treta. Kapitali italian u lejua të dominojë ekonominë shqiptare. Si rezultat, kompanitë italiane u lejuan të mbajnë monopole në shfrytëzimin e burimeve natyrore shqiptare. Të gjitha burimet e naftës në Shqipëri kaluan përmes “Agip”, ndërmarrjes italiane të naftës.



Largimi i ushtrisë italiane

Shqipëria shërbeu si bazë për pushtimin italian të Greqisë në tetor të vitit 1940. Trupat shqiptare si fillim pa luftuar morën pjesë në fushatën ndaj Greqisë, por ata u larguan masivisht nga vija e frontit. Zonat jugore të vendit (duke përfshirë qytetet e Gjirokastrës dhe Korçës) u pushtuan përkohësisht nga ushtria greke gjatë kësaj fushate, por Italia, pavarësisht faktit se nuk fitoi asnjë betejë kundër ushtrisë greke, më në fund mbajti Shqipërinë për shkak të ndihmës së Gjermanisë me fushatën e saj greke dhe pushtimin e mëvonshëm të Greqisë nga Ushtria Gjermane. Shqipëria u zgjerua në maj të vitit 1941, nga aneksimi i Kosovës dhe pjesëve të Malit të Zi dhe Zonës së Vardarit, duke bërë një rrugë të gjatë drejt realizimit të kërkesave nacionaliste për një “Shqipëri të Madhe”. Një pjesë e bregut perëndimor të Epirit equajtur Çamëri u aneksua dhe u vendos nën një Komisioner të Lartë Shqiptar, i cili ushtroi kontrollin nominal mbi të. Kur Italia u largua nga Boshti në shtator 1943, trupat gjermane menjëherë pushtuan Shqipërinë pas një fushate të shkurtër, me rezistencë relativisht të fortë.

Përfitimet që sjellin panelet diellore për njeriun dhe klimën

Ndërsa më shumë njerëz kërkojnë mënyra për të shfrytëzuar energjinë e rinovueshme, përparimet teknologjike vazhdojnë të ndihmojnë për t'i bërë ato më të përballueshëm.

Një studim i fundit tregoi se teknologjia e re e energjisë diellore mund të jetë më e lehtë në portofolin tuaj në të ardhmen e afërt.

Sipas studimit, qelizat diellore tandem perovskit-silikon mund të prodhohen me një çmim minimal të qëndrueshëm prej 0.35 dollarë për vat. Kjo kosto mund të ulet edhe më shumë ndërsa materialet bëhen më të disponueshme. Studimi zbuloi se kostoja e qelizave të silikonit ka të ngjarë të vazhdojë të bjerë dhe pajisjet e lidhura me perovskite do të bëhen më të disponueshme.

Panelet diellore fotovoltaike konsiderohen si standardi në industri. Prodhimi i tyre kushton rreth 0,15 dollarë për vat falë uljes së kostove. Megjithatë, e meta e paneleve diellore fotovoltaike është efikasiteti i tyre 15-22%, të cilin qelizat diellore tandem perovskit-silikon mund ta tejkalojnë lehtësisht.

Në një intervistë Jacob J. Cordell, autori kryesor i studimit, ofroi një këndvështrim interesant për qelizat diellore tandem perovskit-silikon. “Puna jonë bazohet në të dhënat që kemi mbledhur nga prodhuesit e pajisjeve dhe ofruesit e materialeve në vitin e kaluar”, - tha Cordell. “Ne supozuam që modulet të kenë një efikasitet që varion nga 25% në 35%.

Me panelet diellore të gjeneratës aktuale, mund të kurseni deri në 30,000 dollarë gjatë dy dekadave pas instalimit. Ndërsa efikasiteti në panelet diellore vazhdon të rritet, konsumatorët do të marrin kthime edhe më të mira nga investimet e tyre.

Duke kaluar në energjinë diellore, jo vetëm që mund të kurseni para në faturat tuaja elektrike, por gjithashtu mund të ndihmoni në uljen e ndotjes së dëmshme që hyn në ajër.

Për momentin, Cordell beson se qelizat diellore tandem perovskit-silikon do të zhvillohen kryesisht me projekte në shkallë të gjerë, për shkak të efikasitetit të tyre më të lartë. Por kjo mund të ndryshojë me zhvillimin e tregut për teknologjinë.

Sa efektive janë panelet diellore?

Panelet diellore janë mjaft efektive në shndërrimin e dritës së diellit në energji elektrike! Efektiviteti i tyre, shpesh i referuar si efikasitet, varet nga lloji i qelizave diellore të përdorura, kushtet e instalimit dhe vendndodhja.

Panelet monokristaline: Këto janë zakonisht më efikasets, me një normë efikasiteti prej rreth 15-20%.

Panele polikristaline: Pak më pak efikase se panelet monokristaline, me një shkallë efikasiteti prej rreth 13-16%.

Panelet me shtresë të hollë: Në përgjithësi kanë efikasitet më të ulët, rreth 10-12%.

Efikasiteti mund të ndikohet nga disa faktorë

Ekspozimi në rrezet e diellit: Sa më shumë rrezet e diellit të jenë direkte aq më shumë rezulton në performancë më të mirë; Temperatura: Panelet diellore mund të humbasin efikasitetin në temperatura shumë të larta; Këndi dhe orientimi: Këndi dhe orientimi i duhur i instalimit maksimizon ekspozimin ndaj dritës së diellit; Hijezim: Edhe hijezimi i pjesshëm mund të zvogëlojë ndjeshëm efikasitetin e përgjithshëm.

Vlen gjithashtu të theksohet se teknologjia diellore po përmirësohet vazhdimisht dhe përparimet e reja po i shtyjnë vazhdimisht kufijtë e asaj që është e mundur.

Cila është më e mirë për klimën, panelet diellore apo mbjellja e pemëve në të njëjtën sipërfaqe?

Si panelet diellore ashtu edhe pemët luajnë një rol vendimtar në luftimin e ndryshimeve klimatike, por ato e bëjnë këtë në mënyra të ndryshme:

Panelet diellore reduktojnë emetimet e gazeve serrë, duke gjeneruar energji të rinovueshme; U1 varësinë nga lëndët djegëse fosile, duke reduktuar gjurmën e karbonit; Siguron një burim të qëndrueshëm energjie me mirëmbajtje relativisht të ulët; Efektive në rajonet me ekspozim të lartë të dritës së diellit.

Mbjellja e pemëve thith dioksidin e karbonit nga atmosfera dhe çliron oksigjenin, i cili ndihmon në zbutjen e ndryshimeve klimatike; Siguron habitat për jetën e egër, mbështet biodiversitetin dhe përmirëson shëndetin e tokës; Ofron efekte ftohëse, redukon ishujt e nxehtësisë urbane dhe përmirëson cilësinë e ajrit; Kërkojnë kujdesin dhe mirëmbajtjen e duhur dhe ndikimi i tyre rritet me kalimin e kohës kur pemët rriten.

Hapësira: Panelet diellore kërkojnë një hapësirë të caktuar për të gjeneruar energji të konsiderueshme, ndërsa pemët kanë



nevojë për hapësirë që të rriten dhe të lulëzojnë.

Ndikimi i menjëhershëm kundrejt atij afatgjatë: panelet diellore ofrojnë përfitime të menjëhershme duke gjeneruar energji elektrike, ndërsa pemët ofrojnë përfitime afatgjata ndërsa rriten.

Mjedisi lokal: Efektiviteti i secilit option mund të varet nga kushtet lokale mjedisore, të tilla si disponueshmëria e dritës së diellit dhe cilësia e tokës.

Në fund të fundit, zgjedhja më e mirë varet nga qëllimet tuaja specifike dhe kushtet lokale. Një kombinim i të dyja qasjeve mund të jetë ideal, pasi panelet diellore mund të ofrojnë energji të pastër ndërsa pemët përmirësojnë mjedisin dhe kontribuojnë në thithjen e karbonit. Panelet diellore kanë një jetëgjatësi prej rreth 25-30 vjet, pas së cilës ato bëhen mbetje elektronike. Riciklimi dhe asgjësimi i duhur janë thelbësore për të minimizuar dëmin mjedisor.

Pavarësisht këtyre ndikimeve, përfitimet e përgjithshme të paneleve diellore, të tilla si ulja e emetimeve të gazeve serrë dhe sigurimi i një burimi të rinovueshëm të energjisë, shpesh tejkalojnë kostot mjedisore të prodhimit. Panelet diellore mund të reduktojnë ndjeshëm varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe të kontribuojnë në një të ardhme më të qëndrueshme të energjisë. Duke marrë parasysh përfitimet afatgjata, shumë ekspertë besojnë se prodhimi i paneleve diellore ia vlen.

A e dëmton natyrën prodhimi i paneleve solare?

Prodhimi i paneleve diellore ka disa ndikime mjedisore, por është e rëndësishme që këto të peshohen kundrejt përfitimeve të tyre afatgjata...

Ndikimet në mjedis

Konsumi i energjisë: Prodhimi i paneleve diellore kërkon një sasi të konsiderueshme energjie. Nëse kjo energji vjen nga

burime jo të rinovueshme, mund të kontribuojë në emetimet e gazrave serrë.

Përdorimi i materialeve të rrezikshme: Disa faza të prodhimit përfshijnë kimikate të rrezikshme, të cilat duhet të menaxhohen me kujdes për të parandaluar ndotjen e mjedisit.

Përdorimi i ujit: Uji përdoret në faza të ndryshme të prodhimit, duke përfshirë proceset e pastrimit dhe ftohjes.

Përdorimi i tokës: Fermat diellore në shkallë të gjerë kërkojnë sipërfaqe të konsiderueshme toke, e cila mund të ndikojë në ekosistemet lokale dhe jetën e egër.

Përfitimet afatgjata

Panelet diellore reduktojnë emetimet e gazeve serrë, pra prodhojnë energji elektrike pa emetuar gazra serë, duke ndihmuar në luftimin e ndryshimeve klimatike. Përdorimi i energjisë diellore redukon varësinë nga lëndët djegëse fosile, të cilat kanë ndikime të rëndësishme mjedisore dhe shëndetësore.

Panelet diellore kanë burim të qëndrueshëm të energjisë. Energjia diellore është e bollshme dhe e rinovueshme, duke e bërë atë një option të qëndrueshëm për të ardhmen.

Përparimet në teknologji po i bëjnë panelet diellore më efikase dhe të përballueshme, me uljen e kostove dhe rritjen e efikasitetit, duke rritur më tej përfitimet e tyre mjedisore.

Ndërsa ka kosto mjedisore që lidhen me prodhimin e paneleve diellore, shumë ekspertë besojnë se përfitimet e tyre të përgjithshme në drejtim të reduktimit të emetimeve të karbonit dhe ofrimit të energjisë së rinovueshme i tejkalojnë këto kosto. Praktikrat e përgjegjshme të prodhimit dhe programet e riciklimit mund të ndihmojnë gjithashtu në zbutjen e disa prej ndikimeve negative.

Sekretari i Përgjithshëm ripohon unitetin transatlantik në Varshavë: Nuk ka alternativë ndaj NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte vizitoi Varshavën, ku u takua me presidentin polak Andrzej Duda, kryeministrin Donald Tusk, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes Władysław Kosiniak-Kamysz dhe Ministrin e Jashtëm Radosław Sikorski. Sekretari i Përgjithshëm më pas mbajti një fjalim në një ngjarje publike të bashkëorganizuar nga Shkolla e Ekonomisë e Varshavës dhe Instituti polak i Çështjeve Ndërkombëtare.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte vlerësoi Poloninë për udhëheqjen e saj brenda Aleancës, duke përfshirë mbështetjen e saj të fortë për Ukrainën dhe shpenzimet rekord të mbrojtjes, të vendosura për të arritur në 4.7% të PBB-së këtë vit. “Investimi i Polonisë në mbrojtje është një shembull për të gjithë aleatët. Jo vetëm që jeni në krye të listave të NATO-s, ju planifikoni të shpenzoni edhe më shumë”, - tha ai.

Në fjalimin e tij kryesor, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi forcën e lidhjes transatlantike dhe përshkroi rrugën e NATO-s drejt Samitit të ardhshëm në Hagë.

“Kur bëhet fjalë për mbajtjen e sigurt të Evropës dhe Amerikës së Veriut, nuk ka alternativë ndaj NATO-s”, - tha ai, duke theksuar se nuk është e mundur të imagjinohet mbrojtja e Evropës pa Aleancën.

Ndërsa lufta e Rusisë kundër Ukrainës po vazhdon dhe bashkëpunimi i saj ushtarak me Kinën, Iranin dhe Korenë e Veriut intensifikohet, Rutte paralajmëroi se presidenti Putin “nuk ka hequr dorë nga ambicia e tij për të riformuar rendin global të sigurisë”. Ai nënvizoi se një Aleancë e fortë transatlantike mbetet themeli i sigurisë evropiane dhe se aleatët më të fortë evropianë janë një pasuri unike strategjike për Shtetet e Bashkuara - duke i lejuar Amerikës, tha ai, të “promovojë paqen përmes fuqisë në skenën globale”.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte përsëriti besimin e tij në angazhimin e vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara ndaj NATO-s dhe nenit 5. “Dëgjoni Presidentin Trump, i cili ka deklaruar vazhdimisht angazhimin e tij për një NATO të fortë. Dëgjoni mbështetjen e fortë dypartiake në Kongresin e SHBA, - tha ai. - Dhe dëgjoni popullin amerikan”, tre të katërtat e të cilëve mbështesin NATO-n, sipas një sondazhi të fundit të Gallup.

Z. Rutte theksoi gjithashtu se angazhimi i SHBA-ve ndaj NATO-s vjen me një pritshmëri të qartë: që aleatët evropianë dhe Kanadaja të marrin përgjegjësi më të madhe për sigurinë tonë të përbashkët.

Duke parë përpara Samitit të NATO-s në Hagë, Sekretari i Përgjithshëm tha se Aleanca do të “fillojë një kapitull të ri për Aleancën tonë transatlantike. Ku ne ndërtojmë një NATO më të fortë, më të drejtë dhe më vdekjeprurëse, për t’u përballur me një botë më të rrezikshme”.

Aleatët e NATO-s diskutojnë rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes dhe kapaciteteve industriale me Komisionerin Evropian për Mbrojtjen dhe Hapësirën

Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e NATO-s, Radmila Shekerinska mirëpriti Komisionerin Evropian për Mbrojtjen dhe Hapësirën, Andrius Kubilius, në selinë e NATO-s për një takim me aleatët në Këshillin e Atlantikut të Veriut.

Znj. Shekerinska theksoi nevojën që Evropa të rrisë shpenzimet e mbrojtjes dhe të rrisë prodhimin e mbrojtjes, duke vënë në dukje se një mbrojtje më e fortë evropiane do të kontribuojë gjithashtu për një Aleancë më të fortë. Duke pranuar se NATO dhe BE janë partnerë të natyrshëm dhe të domosdoshëm, ajo theksoi se përpjekjet e drejtuara drejt industrisë evropiane të mbrojtjes dhe zhvillimit të aftësive duhet të jenë plotësuese, koherente dhe të ndërveprueshme me NATO-n dhe të përfshijnë sa më shumë që të jetë e mundur aleatët jo-BE.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi gjithashtu rolin vendimtar që NATO dhe BE kanë luajtur për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet. Ajo nënvizoi rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të Ukrainës si në fushën e betejës ashtu edhe në tryezën e bisedimeve.

Znj. Shekerinska nënvizoi rëndësinë e vazhdimin të shkëmbimeve NATO-BE për të nxitur transparencën në çështjet me interes të qartë të përbashkët dhe për të eksploruar rrugët e mëtejshme të bashkëpunimit. Ajo përshëndeti Librin e Bardhë për Mbrojtjen Evropiane dhe u shpreh se priste me padurim të punonte në një mënyrë të vërtetë bashkëpunuese gjatë zbatimit të tij.



Komiteti Ushtarak i NATO-s viziton Suedinë

Komiteti Ushtarak i NATO-s vizitoi ishullin Gotland dhe Luleå në Suedi, me ftesë të Shefit Suedez të Mbrojtjes, Gjeneral Michael Claesson. Kjo ishte vizita e parë e Komitetit Ushtarak në Suedi, që kur vendi u bë anëtar i 32-të i Aleancës së NATO-s, në mars 2024.

Gjatë gjithë vizitës, Komiteti Ushtarak u informua mbi strategjinë e sigurisë dhe mbrojtjes të Suedisë, mjedisin e saj gjeostrategjik, konceptin e mbrojtjes totale dhe aftësitë moderne ushtarake. U diskutua gjithashtu për bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh të mbrojtjes së Suedisë me aleatët rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Kryetari i Komitetit Ushtarak, Admirali Giuseppe Cavo Dragone, nënvizoi rëndësinë e kësaj vizite për të dëshmuar nga dora e parë nivelin e lartë të aftësive mbrojtëse të Suedisë, profesionalizmin e personelit të saj ushtarak dhe civil dhe se si e gjithë kjo kontribuon ndjeshëm në mbrojtjen kolektive të Aleancës.

Admirali Cavo Dragone theksoi sigurinë e pozicionit të Suedisë brenda NATO-s dhe përkushtimin për të garantuar sigurinë e përbashkët mes të 32 aleatëve.

Komiteti Ushtarak vizitoi objektet ushtarake suedeze në ishullin Gotland, një vend me rëndësi gjeostrategjike në rajonin e detit Baltik për forcimin e krahut verilindor të NATO-s. Komiteti Ushtarak pati gjithashtu mundësinë të takojë me Regjimentin e 18-të të Blinduar Gotland dhe të mësojë më shumë rreth aftësive detare dhe tokësore të Suedisë.

Komiteti Ushtarak vizitoi gjithashtu Luleå, të organizuar nga Shefi i Forcave Ajrore, gjeneralmajor Jonas Wikman dhe Shefi i Ushtrisë, gjeneralmajor Jonny Lindfors, ku mësuan më shumë se si aftësitë e specializuara të Suedisë janë përshtatur me mjedisin strategjik të Veriut të Lartë. Në Luleå, admiralët dhe gjeneralët nga Komiteti Ushtarak patën mundësinë të angazhoheshin me rekrutët dhe u informuan mbi qasjen e gjithë shoqërisë dhe investimin e Suedisë në aftësitë e ardhshme të forcave.





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES

Qendra e Personel Rekrutimit



do të rekrutojë kandidatë për studime në

**AKADEMINË USHTARAKE NË MODENA, ITALI,
1 (NJË) KUOTË, DEGA “GJITHARMËSH”**

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së

Personel Rekrutimit është deri më **11 prill 2025**

Për më shumë informacion kliko në linkun:

<https://www.mod.gov.al/rekrutime>

Bëhupjesë
ForcatEArmatoSura
KarrierëUshtarake
FAShqiptare